



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XIV i botimit, nr. 153, Korrik 2016

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

100 VJET ARSIM DHE KULTURË NË DUKAGJIN

NDIHMESE PËR STUDIMIN

Të nderuar organizator të studimit “100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin”

Faleminderit që më dhatë mundësinë të jap ndihmesën time modeste për historikun “100 vjet arsim në Dukagjin. Në fakt unë nuk e njoh zhvillimin e arsimit në atë zonë. Do të përpigëm të kujtoj pak gjëra nga viti shkollor 1967-68 në të cilin kam qenë mësues aksionist në shkollën 8.vjeçare të Bregut të Lumit. Kam mbërrit aty në tetor të vitit 1967. rruga ka qene e hapur nga bora, flas për rrugën nga Thethi.

2

THETHI, ATY KU KALUAM VITE TË RINISË

Po shkruaj disa rreshta për gazetën “Dukagjini”, në kuadrin e nismës së Shoqatës “Atdhetare Dukagjini” me temë “100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin” që mbushen vitin e ardhshëm. Pas dy vitesh në gjimnazin “Jordan Misja” Shkodër, në vitin 1966, më emrojnë drejtor shkolle në Theth, duke u përgjigjuar...

SHTATË TË VRARË QË LYPIN GJYQ!

3

Dukagjini ka pësuar shumë masakra por as një më të ligë

Ata ishin shtatë, rebel të një zone shumë të nxehtë antizogiste. Me 13 janar 1923 ishin sulur ashpërsisht të kundër Postes së Xhandarmerisë në Lekbibaj të komanduar nga Mujë Hoxha. Ata ishin shtatë flakë vetëtimash dhe nuk kishin lënë gurë pa luajtur dhe mjet pa përdorur në dobi të opizicionit . Kishin vite që bënin jetën e koçakut nuk pranoinin t’i bindeshin qeverisë, nuk nihnin dhe nuk e pranoinin si autoritet. Ata ishin shtatë burra (tre mësues dhe katër nikaj) sy pa trembur të pa përkulur si giza përpara forcës së armëve dhe të butë si dylli para fjalës besë.

Me emigrantët shqiptar në shtetin Helen

- NJË BISEDE NE AVION -

Dr. Nike Bunjaj,

Shkrimtar dhe Publicist

4

Mëngjes pranveror. Ishte data 20 prill... Në aeroportin e “Nënë Ter-eza” kishte mjaft njerëz që prisnin orën e nisjes së avionit, sipas linjave ndërkombëtare. Ishte ora e 06.00 mëngjesit. Petriri dhe Aleksandri, pasi u bene kontrollin e duhur doganieret, u nisen drejt avionit të linjës Rinas-Athine, pra drejt kryeqytetit helen. Hipën në avion, gjeten vendet ...



MARASH KOLA NJË JETË TË TËRË NË SHËRBIM TË ATDHEUT

5

- NË 85 VJETORIN E LINDJES -

Mirënjohje për të gjitha ata kuadro e punonjës të ndryshëm, bijë e bija të Dukagjinit, të cilët me zotësi, me dijë e kulturë, me ndërgjegje dhe përkushtim të spikatur, kanë punuar e punojnë për të naltësuar personalitetin e tyre, dhe emrin e mirë si dukagjinas që gëzojnë.

Respekt e mirënjohje edhe për shoqatën e gazetën tonë për punën që ka bërë në njohjen e këtyre figurave si model për brezin e ri, për sot dhe për të ardhmen, që ia zbardhin faqen vendlindjes së tyre, kudo ku punojnë dhe jetojnë.

Mhill Pali, një intelektual i Gjurajve, që rrit vlerat e Dukagjinit

6

Një burrë e qeshur, goje ëmbël, kompetent në ato që diskuton, sfidant i kohës dhe i moshës ... Kështu do ta cilësoja Mhill Pain, komandantin siç e thërrasin të gjithë.

Mendoj, që këtyre figurave ju a kemi pasur borxh me kohe të pasqyrojmë vlerat e tyre për nderin, që i bëjnë, me një kontribut të shkëlqyer fshatit të tyre të lindjes, Gjurajve, i cili është krenar për të tillë bij, por edhe më gjere- Dukagjini dhe shoqëria, që e njohën dhe patën marrëdhënie pune e shoqërie me te.

DUKAGJINI SHUMË I BUKUR, POR MALËSORËT E KËTIJ VENDI MË TË BUKUR KANË SHPIRTIN

6

- BASHKËBISEDIM ME ZYLI KRAJËN -

Rasti e solli që një ditë në këtë pranverë, bashkë me time shoqe, të gjendemi në klinikën e Dr. Besim Kraja për të vizituar dhëmbët. Gjetëm një njeri shumë të përgjegjshëm, i qetë, me një klinikë mjaftë të mirë dhe disa njerëz në radhë për punët e tyre. Kur ne u futëm brenda ishte buzëqeshja që në pritë e para. U përshëndetëm dhe pa filluar që të bisedonim për dhëmbët, ra bisedë se nga ishim ne.

100 VJET ARSIM DHE KULTURË NË DUKAGJIN

NDIHMESE PËR STUDIMIN

Të nderuar organizator të studimit “100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin”

Faleminderit që më dhatë mundësinë të jap ndihmesën time modeste për historikun “100 vjet arsim në Dukagjin. Në fakt unë nuk e njoh zhvillimin e arsimit në atë zonë. Do të përpiqem të kujtoj pak gjëra nga viti shkollor 1967-68 në të cilin kam qenë mësues aksionist në shkollën 8.vjeçare të Bregut të Lumit. Kam mbërrit aty në tetor të vitit 1967. rruga ka qene e hapur nga bora, flas për rrugën nga Thethi.

Bregu i Lumit ishte qendra administrative e zonë së Dukagjinit. Aty ishin perqendruar: Kom.PPSH- me sekretar Mark Ndou, Kom.Ekzekutiv-me Kryetar Kole Noshi dhe sekretar Kole Zefi, shkolla 8 vjecare, spitali me Drejtor dr. Muhamet Bala, klinike dentare me Dr.Musa Bizaku, farmaci me dr. Bashkim Laçej, Shtëpia e kulturës në përfundim, PTT, hidrocentrali i vogël, repartit ushtarak, policia dhe dyqanet e zonës, ndërmjet të cilëve një klub i vogël. Shkodra lidhej me Bregun e Lumit me rrugën e vetme automobilistike që kalon nga Qafë Thorja, që funksiononte nga fundi i qershorit deri në nëntor. Pjesën tjetër të kohës shkuarjen dhe ardhjen nga Shkodra e kemi bërë me shumë vështirësi, në këmbë nëpër borë, nëpër Qafë Thore ose edhe nga Qafa e Shoshit nëpër Gurin e kuq. Rruga automobilistike Shkodër-Shosh—Breg Lumii ishte ende në projekt ose në fillesat e saj. Si në verë ashtu edhe në dimër këto udhëtime kanë lënë një mbresë të pashlyer për bukuritë e atyre anëve dhe mikëpritjen e paharueshme të njërzëve të varfër të atyre anëve. Janë këto arësytet që unë, sa isha kryetar i Këshillit të Qarkut i kushtova rëndësi projektit të zhvillimit të Dukagjinit, sidomos ndërtimit të unazës turistike Shkodër-Shosh-Theth-Koplik-Shkodër. Fatmirësisht një pjesë e mirë e kësaj unaze është realizuar. Zonat rreth kësaj rruge gjithnjë e më shumë po ripopullohen.

Me siguri edhe ju i dini, por unë po jua rikujtoj disa emra që mund të jenë të dobishëm në nismën tuaj, pasi janë ende ne jetë.

1. Tahsim Mlloja ish-Drejtor i shkollës së Thethit, 2. Mehdi Shkreli ish-drejtor i shkollës Xhan, 3. Mahir Hoti, 4. Fadil Galiqi ish-mësues i shkollës Palaj- Shosh, 5. Bashkim Lacej, ish Farmacist, 6.Ahmet Osja, ish- agronom, 7. Tonin Çoba, ish-shofer i ushtrisë, 8. Nazmi Kruja ish administrator i arsimit, etj.

Në vitin shkollor 1967-68 në Shkollën 8 vjeçare në Bregun e Lumit (shkolla qendër) e Dukagjinit, të gjithë mësuesit ishin nga Shkodra. Drejtor Harun Haruni anglisht, Filip Guraziu matematikë. Në tetor 67 arrita edhe unë si aksioniste, për lëndën matematike, Aishe Karaj Hoxha gjuhëletërsi, Skënder Haveri biologji, Muhamet Shala gjeografi; aneks i shkollës tetëvjeçare ishte edhe shkolla fillore me mësuese Lena Pali. Të gjithë të rinjë 25-26 vjeç

Numri i nxënësve nuk më kujtohet, por di se deri para 10 vitesh ka qenë amza, madje edhe disa rregjistra. Mund të them se nuk i kalonte 30-40 veta, dhe vinin nga fshatrat përreth. Lotaj-Vuksanaj-Pecaj-Abat-Gimaj etj. në numër pothuajse të barabartë vajza e djem.

Në disa foto që po ju dërgoj të bëra në vitin 1968, parësisht nga cilësia janë mjaftë domethënëse. Më vjen keq që sot ndërtesat e asaj kohe, përjashtuar spitalin dhe dyqanet e komunën (ish shkolla) që u dogj para disa kohësh, nuk janë më.



Grup mësuesish në Breglumi në vitin 1968 Breglumi 1968

Tonin Ujka kishte ardhur aksionist, pa pagese (paguhej nga kooperativa) që ngarkuar për aktivitetet kulturore. Ishte gati e perfunduar Shtëpia e kulturës. Në nëntor 1967 kam shfaqur për herë të parë në sallën e mbyllur, plotësuar me karrige, filmin “Çapajevi” me një aparat 16 mm, që e pata gjetë nën shtrat, e me të cilin (ose me një tip si ai) pata punuar në shtëpinë e pionierit në Shkodër në vitet 54-55. Në shtator 1968 morëm nga repartit ushtarak një aparat filmi 35 mm. Meti nëpërmjet një korrieri sillte filmat nga Kinema “Republika”



Grup nxënësesh në Breglumi 1968

Shkolla kishte një bibliotekë të vogël, për të cilën kujdesej Aishja.

Ndërtesa shkollore kishte katër dhoma në dispozicion për katër klasa:V-VI-VII-VIII. Secila

me jo me shume se 10- 20 nxënës. Klasat qenë në katin e parë. Atë vit niveli arsimor i mësuesve që, ndoshta me i mirë se në të gjitha shkollat tetëvjeçare të Shkodrës. Të gjithë mësuesit ishin me arsim universitar 4 vjeçar. Në katin e dytë që fjetorja dhe kuzhina për mësuesit meshkuj. Mësueset Lena dhe Aishja flinin në ndërtesën e shkollës fillore, përtej lumit të Shalës. Kalonin nëpër urën e drunjtë.



Ish shtëpia e kulturës dhe shkolla fillore në Breglumi.

Në ato vite për të cilat po flas (1967-68) u kujdesëm shumë për amzën dhe regjistrat e klasave. Viti filloi shtator 1967 dhe mbaroi në maj 1968. Nuk që shkollë verore. Disiplina formale dhe ajo e mësuesi qenë në shkallën më të lartë. Mesa më kujtohet ditarët kontrolloheshin përherë nga drejtori. Tekstet ishin me mungesë. Nxënësit shfrytezonin tekstet e nxënësve nga viti i kaluar, që i grumbullonte shkolla. Mësimi zhvillohej rregullisht madje edhe në ditët me shi. Unë krijova një laborator fizike modest me ndihmen e administratorit të seksionit të arsimit Nazmi Kruja. Në atë vit shkollor Bregu i Lumit nuk pati borë të madhe, kështu që nuk pati mungesa.. Ne fakt klima në Breg të Lumit që e ngjashme me atë të Shkodrës. Në nëntor 1967 vdiq Shkurte Pal Vata. Arkivoli erdhi vonë pasdreke në shkollën tonë dhe të nesërmen u transportuar për ceremonitë në Pecaj. Periudha nëntor 1967 deri tetor 1968 (kur unë u largova) që një periudhë shumë intensive në Bregun e Lumit. Vullnetarë, makina me materiale ndërtimi, peligrinazhe deri në Pecaj kishte çdo ditë. Ne mësuesit ndihmonim në shkarkimin dhe sistemimin e materialeve të ndërtimit. Kishte drejtues që punën e mësuesit e shihnin si punë të rahatshme. Këto janë disa kujtime të mia të një viti në 100 vite histori, madje ndonjë gjë (sidomos numrat) mund të jetë jo krejtësisht e saktë, pasi kanë kaluar shumë vite, por duke i rishikuar e krahasuar me mendimet e të tjerëve mund të korrigjohen.

Suksese e punë të mbarë.

Prof.dr. GJOVALIN KOLOMBI

THETHI, ATY KU KALUAM VITE TË RINISË

Po shkruaj disa rreshta për gazetën “Dukagjini”, në kuadrin e nismës së Shoqatës “Atdhetare Dukagjini” me temë “100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin” që mbushen vitin e ardhshëm.

Pas dy vitesh në gjimnazin “Jordan Misja” Shkodër, në vitin 1966, më emrojnë drejtor shkolle në Theth, duke u përgjigjuar kështu “thirrjes së partisë”.

Shkodra vlonte nga lëvizje revolucionare të stilit kinez dhe veçanërisht në luftën kundër fesë. Kështu ne mendonim se ishim më të qetë në atë skaj të largët.

Përshtypja e parë që më tërhoqi ishte mikpritja e banorëve, dhe ngrohtësia e tyre, pasi nuk ishte e lehtë të largohesh nga qyteti dhe familja drejt atyre zonave të ashpra dhe të vështira.

Mbrëritja në shkollë dhe u njoha me mësuesit. Në mbrëmje erdhi në shkollë Tomë Balbona, ish nxënësi im i gjimnazit në Shkodër që banonte familjarisht në Theth. Sot ai ndodhet familjarisht në SHBA, i arratisur shumë vite më parë. Ai na ftoj për darkë në kullën e tij të bukur. Në hyrje, më la mbresë një shqiponjë pa yll e gdhendur në dru. Ata e punonin drurin shumë bukur., kjo dukej kudo në atë kullë e tyre. Një mësues i tha: -ku është ylli. Ata u përgjigjen se kështu e ka pasur edhe Skënderbeu.

Ata natë bisedat shkuan deri pas mesnate, për shkollën, jetën, ekonominë, hallet e deri te Shegu i Dhëneve ku do të kalonim gjatë periudhës së dimrit për të shkuar në Shkodër. Të nesërmen më thërret sekretari i partisë dhe më thotë: -kujdes, ajo familje është keq politikisht. Unë i thashë së ata janë familje e mirë dhe duhet ti mbajmë afër. Ai nuk e zgjati.

Në shkollë jetonim si një familje. Nxënësit vini nga larg dhe me shumë vështirësi, por ishin të sjellshëm e të dashur dhe kishin dëshirë për shkollim. Vëçanërisht dimri ishte i vështirë, por fshati na ndihmonte shumë. Për çdo gëzim apo fatkeqësi ne ishim pranë shtëpivë të tyre. Kishim marrëdhënie shumë të mira me banorët e fshatit e vëçanërisht me Nikën Tomën, Leksë Simonin, Gjokë Kolë, etj.

Thethi është disi më i zhvilluar se zona tjetër në pikpamje ekonomike dhe shoqërore, pavarësisht që e gjithë zona ishte në një prapambetje të madhe. Në atë kohë ne ndërmorëm nismën “për higjienizimin e fshatit” që gjeti mbështetje nga i gjithë fshati. Kjo ndihmoi shumë në fshat dhe u vlerësua në rang kombëtar.

Në lagjen Gjellaj ishin burrat më krenar dhe fjalë pak. Ishte orjentimi që të hiqeshin kryqet mbi pul-lazet e shtëpivë. Porosita mësuesin që kishte në patronazh lagjen që të vpronte me kujdes e takt. Ai kur u kthye më tha se u lodha kot sepse në fund të bisedës një nga malësorët më tha: “hapi krahët dhe formohet kryqi, s’ka vlerë se po e heq nga pul-lazi”.

Nga puna jonë, përveç të tjerash, dolën shumë mësues vendas që zevëndësuan ata që kishin ardhur nga qyteti apo zonat e tjera.

Me gjithë vështirësit dhe hallet e kohës, në miqësi dhe bashkëpunim me malësorët ne kaluam vite të rinisë tonë në ato male.

Sot kur takohemi me ish nënësit dhe banorët e atyre maleve ndiejmë respekt dhe dashuri reciproke, dhe kujtimet nuk kanë të sosur.

Është një vlerë e shtuar nisma e Shoqatës “Atdhetare Dukagjini” për të studiuar dhe kujtuar punën njëshekullore që është bërë në ato zona për arsimin dhe kulturën , e cila duhet përshëndetur dhe ndihmuar.

TASIM MLLOJA

SHTATË TË VRARË QË LYPIN GJYQ!

Dukagjini ka pësuar shumë masakra por as një më të ligë

Ata ishin shtatë, rebel të një zone shumë të nxehtë antizogiste. Me 13 janar 1923 ishin sulur ashpërsisht të kundër Postes së Xhandarmerisë në Lekbibaj të komanduar nga Mujë Hoxha. Ata ishin shtatë flakë vetëtimash dhe nuk kishin lënë gurë pa luajtur dhe mjet pa përdorur në dobi të opizicionit . Kishin vite që bënin jetën e koçakut nuk pranoin t’i bindeshin qeverisë, nuk nihnin dhe nuk e pranoin si autoritet. Ata ishin shtatë burra (tre mëturës dhe katër nikaj) sy pa trembur të pa përkulur si giza përpara forcës së armëve dhe të butë si dylli para fjalës besë. Ju dorëzuan në mënyrë naive në besë të Zotit një të pa burri dhe morën si shpërblim disa batara pas shpine duke ecur të prangosur në një rrugë pylli të shkretë në Qafë Millë diku ndërmjet Bujanit dhe Krumës. Kanë kaluar 90 vjet dhe akoma nuk është zbardhur misteri i asaj masakre nga më ulëtat që kanë parë e përjetuar malet e Dukagjinit. Në se i referohemi “Hyllit të Dritës” të vitit 1924 kjo shkronjëtoe fisnike ka nënvizuar:” Një far muhaxherimi prej Gjakove i veshur si gjysmë oficer shqiptarë, para këtyre ditëve vranëte kthillte në Prefekturën e Gjakovës. Në emër të qeverisë shqiptare u çun fjalë koçave të Nikaj Merturit se ishin të falur për Bajram dhe për ketë të mblidheshin të gjithë në një vend të caktuar. Ditën e caktuar shkuan koçakët, ku oficeri zgjodhi 7 veta që ishin në gjak e varrë me Gash e Krasniqe të cilët lidhi dhe i nisi për në Krumë, kurse të tjerët i lëshoi të shkonin në shtëpitë

e tyre. Ata të shtatë i mori të lidhur dhe kur mbërritën ndërmjet Bujanit dhe Krumës dikush doli dhe i varu të gjithë”1. Emri i zabit ahmetist (Beqir Rexha) që i thirri në besë rebelet ka qenë njohur edhe për bëma të tjera famëkeqe në Nikaj Mertur. Ka vite që ky emër i urryer është tretur në mjegullnajën e kohës si rezultat një kujtese historike me drita të shkurta që kemi si populli. Sikur të mos ishte



Dr.Mark Palnikaj i cili gjeti drynin e një kolkozi të ndryshkur të Arkifakteve që flenë në AQSH jo vetëm emri besëprerit Beqir Rexha por akoma më keq viktimat e tij Lulash Hasan Papekaj, Mark Zef Kukaj, Prelë Mehmet Ramaj, Marash Ndue Qehaja , Ndue Bajram Papekaj Beqir Gjon Rosaj, Pashk Mark Hasvataj kishte rrezik të mbeteshin për shumë kohë në pluhurin e një harrese të pa falshme.

Kjo vrasje nuk nevojë për emër pasi përmbledhë qartësisht një histori dhe një tragjedi gjaku të pa fajshëm te rrjedhur vadë nga dejtë e atyre fiseve emblematike që çdo rrethanë mbartën vitalitet dhe burrnimin kombëtarë. Qeveria e Tiranës që trumbetonte drejtësinë, progresin dhe modernizimin e vendit mbahej në këmbë më bashibozukë të tmerrshëm, inkuizitor duar përgjakur me kompetenca të pakufizuara, ndaj kundërshtarëve politik që vepronin me instinkte të pa fre ndaj kujtdo që nuk donte “Ovgustin” e tyre : Gazeta opozitare “Ora e Maleve” Nr 32 komplet në ballinën e parë dhe një të tretën e faqes së dytë shpalosë kryeartikullin “Shtatë të Vramë lypin gjyq” :”Shtatë malësorë prej Nikaj Mertauri i ka gri qeveria e Shqipërisë në besë të vet, më thotë një kasnec i atyre anëve ka më dorëzo do letra - Jo mos thuaj qeveria e Shqipërisë por ai nuk më la me fol. Asha Zotin kërkush tjetër në fytyrë të diellit veç qeveria e Shqipërisë” 2. Me këto rrallë fillon artikulli shigjetues si rrufeja që ka për autor një fart nga Dukagjini i cili nuk ka rrezikuar që verë emrin.

Në lidhje me ketë ngjarje me 25 gusht 1924 janë mbledhur 39 përfaqësues të Nikaj Mërturit ku shkruan një letër fletore “Bashkimi” 3. “Sa ka ardhur Demush Gjakova me 7.9.9 të VII ka mbledhë popullin nja 300 vetë të kisha e Nikajve dhe ka thanë me falë koçakun, por të vijë kush ashtë në mal në besë të zotit dhe qeverisë Ne u besuam njerëzve te ardhur prej Qafës së Kolçit të veshur me petkun qe-

verisë”4. Nga ky dokument rezulton se kanë qenë 21 vetë që janë dorëzuar, madje janë dorëzuar konditë në mënyrë soleme duke shtënë me pushkë kur u nisën për në Tropojë sikur të ishin krushq. Në letër thuhet se i kanë lënë tre ditë pa ngrënë, pas tre ditësh 14 i lëshuan kurse të shatë fat keqët i nisën për në Krumë gjoja për të dorëzuar gjyqit dhe sa po kanë dalë në Qafë Millë i vrau xhandarmeria të gjithë. Në atë le letër të gjatë proteste ku kërkohet zbardhja e rrethanave misterioze të kësaj vrasje pa gjyq. “Me i pas vra gjyqi,... s’kishim thanë gjë tjetër veç paçin marrë të keqen fisit e gjithë Shqipërisë, përndryshe na lypim gjyq për në qofshim shqiptarë dhe bijtë të një ligji, kundra gjithë atyre që i thirrën me ndore e me besë dhe i vranë pa i çue në derë të gjyqit”5. O tempora o mors! U vranë 7 njerëz dhe sikur të ishin vranë shtatë pula, as kush nuk mbajti as një përgjegjësi për ketë masakër e cila nuk u zbardh kurrë. Ky shkrim i shkurtër le të shërbejë si një homazh i munguar mbi turrën eshtreve të martirëve antizogist të Dukagjinit . Amanet ju o malet . Amanet sidomos ju malet e Nikaj- Mërturit mos i harroni! Mos harroni ketë ngjarje se këta burra kurrësi nuk meritonin një vdekje të tillë. Një masakër e tillë e pa besë është një testament i shkruar me gjak mësim për të mirën dhe kushtrim kundër së keqes: Edhe sot pas 90 vitesh shtatë të vranët e Nikaj Merkurit lypin gjyq ! Historia është gjykuesja më e mirë. Politika shpesh i bën dajntë engjëj dhe anasjelltas por si do të frynë erërat e politikës Ahmet Zogu e ka vendin në bankën e të akuzuarit nga historia si vrasë i pa besë i shqiptareve.

PRELE MILANI

Shoqëria dhe individi

Nga Mexhit DEMIRI

Jeta shoqërore ashtu si natyra ka ligjet e veta. Përcaktuese janë ligjësitë e përgjithshme, marrëdhëniet në prodhim dhe kushtet materiale. Njeriu është produkt i shoqërisë dhe i rrethanave. “Çdo shoqëri, -thotë Sokrati i Lashtësisë, - e krijon modelin e njeriut sipas vetes së saj”. Shoqëria që lame pas krijoi modelin e njeriut, në kushte e rrethana historike, me ndjesi e identitet të shtuar kombëtar. Është shoqëria, janë marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore që përcaktojnë shkallën kulturore e të sjelljes së individit. Një shoqëri e përparuar dhe e moralshme, krijon individë të kulturuar e të sjellshëm. Natyrisht, raporti shoqëri-individ është reciprok. Por, në këtë reciprocitet, përcaktuese është shoqëria, janë marrëdhëniet që krijojnë, në kohë e në hapësirë sipas ligjësisë së përgjithshme të zhvillimit shoqëror dhe të ligjeve e të normave juridike. Në themel të këtij raporti ngrihen interesat shoqërore, interesi i përgjithshëm dhe i veçanti, personal. Në këtë raport, parësore, primare është interesi i përgjithshëm, që është bazë e jetës së shoqërisë dhe e çdo individi në veçanti.

Vetëm nëpërmjet interesit të përgjithshëm, mund të plotësohen interesat personale dhe prirjet e veçanta të individit. Shoqëria dhe individi nuk janë fenomene të ndara. “Në thelb, thotë V. Gëte, - jemi qenie kolektive”. Më shumë njerëzit i bashkon karakteri shoqëror i pronësisë dhe shpirtëror, terriori dhe ndërgjegjja kombëtare, gjuha dhe traditat, idetë dhe botëkuptimi se sa mentaliteti i një individi, i cili mbart në vetvete dhe prirje egoiste, individualiste, që po të shumohen shkojnë në dëm të jetës publike e të shoqërisë në tërësi. Në këtë raport përcaktuese mbeten marrëdhëniet në prodhim dhe

karakter i pronësisë.

Para viteve ‘90 të shekullit të kaluar ishte zotëruese prona shtetërore, publike. Pas këtij viti, prona publike u shemb dhe u zëvendësua me pronësinë private mbi mjetet e prodhimit, rast unikal në ndryshimin e sistemeve. Ndodhi ajo që pritej. U shpikën teori pas teorie. Lindi teoria absurde “Terapia e shokut” dhe e “Çekut të bardhë” që nënkuptonte asgjësimin fizik të krejt bazës materialo-teknike, industriale e bujqësore dhe kthimin e ekonomisë së vendit në nivelin “zero”. Kjo çoi në atë që, interesi i veçantë të vihet mbi interesin e ërgjithshëm.

Individi dhe interesat e tij të vihen mbi interesin e shoqërisë. Individi dhunoi shoqërinë. Politika e mbështetur në këto marrëdhënie diskriminuese shkatërroi bazën ekonomiko-shoqërore, veprat industriale, bujqësore, kulturore e arsimore dhe rrëmbëu e privatizoi çfarë mbeti, nga ajo që ishte ndërtuar, me mund e djersë, gjatë periudhës pesëdhjetëvjeçare duke e çuar vendin në varfëri dhe në papunësi masive.

Mëse një milion të papunë dhe mbi një milion të tjerë të larguar në emigracion pa kthim, që është një dramë e vërtetë.

Vetëm në vitet 2002-2012 u larguan nga Shqipëria mbi pesëqind mijë shqiptarë, që është një eksod i dytë pas atij të vitit ‘90. Shkatërrimi i pronës publike bëri që 5% e popullsisë, të zotërojnë 95% të ekonomisë kombëtare. Pakica vihet mbi shumicën. Ajo pasurohet, ndërsa shumica shfrytëzohet e varfërohet duke iu nënshtuar ligjit të “hunglës”, më të fortit ndaj më të pafuqishmit “Nuk mund të pranohet, - thotë Manlio Dinuçi, sociolog i shquar italian, - që në kohën e sotme 10% e të pasurve të zotërojnë rreth 80% të burimeve njerëzore”. Mosbarazia shoqërore bëhet shkak i konflikteve shoqërore dhe i luftërave. Një shtresë vihet kundër një shtrese.

Individi vihet kundër individit. Mirëqenia apo lumturia e një shtrese nuk mund të ngrihet në kurritz të një shtrese tjetër. “Ne duam të jetojmë nga lumturia e njeri-tjetrit, - thotë Charlie Chaplin, - jo nga mjerimi i njeri-tjetrit”. Në këtë kuptim, nuk mund të ketë lumturi individuale pa mirëqenie të përgjithshme

e shoqërore. Sjellja e individit, - thotë sociologu, - mund të kuptohet vetëm në kufijtë e sjelljes në shoqëri. Është shoqëria, janë marrëdhëniet në prodhim që përcaktojnë sjelljen e individit. Në të kundërt, shoqëria kthehet në anarki, siç është shoqëria e sotme shqiptare. Shoqëria, në bazë të ligjësisë objektive, nxjerr normat juridike dhe një sere normash morale, universale të pranuar nga shoqëria. Individi nuk mund të merret i shkëputur nga marrëdhëniet shoqërore. Njeriu është i prirë të jetojë në shoqëri se është pjesë e saj dhe kjo e shtyn atë të zbatojë rregullat ligjore e morale. Njeriu, - thotë Xhon Lok, - është produkt i mjedisit në të cilin rritet dhe edukohet. Teoria e përhapur aq shumë në ditët e sotme e së “drejtës” të individit, tenton ta shkëputë individin nga shoqëria. Liritë dhe të drejtat e tij t’i shkëpusë nga ato të shoqërisë deri dhe t’ia kundërvejë me pretendimin e “lirisë” së individit dhe të drejtave të tij, që realisht bien ndesh me të shoqërisë, ku ai është pjesëtar. Individi nuk ka vetëm të drejta, por dhe detyra, që rrjedhin nga marrëdhëniet në shoqëri. Më së pari kryhen detyrimet ndaj kombit, familjes e shoqërisë. E drejta e individit merr vlerë vetëm në kuadrin e të drejtës së përgjithshme, civile, njerëzore.

Njeriu është qenie sociale. Ndarja e të “drejtës” së individit nga e drejta universale, njerëzore, çon dhunshëm në kundërvënien e individit ndaj shoqërisë e familjes, që është qeliza bazë e shoqërisë e cila, trashëgon virtyte dhe traditat më të mira të qytetarisë shqiptare, që u shfaqën dukshëm para viteve ‘90. Traditat e mira, ruajnë dhe konsolidojnë identitetin e një kombi. Nga e shkuara trashëgojmë gjithë të mirat: identitetin kombëtar, bekimin dhe dashurinë familjare që është jetësore. Familja është e shenjtë, në kuptimin më të mirë të fjalës. Ajo është e shenjtë se krijon trashëgiminë gjinore. Të jep dashurinë e fëmijëve, rrit solidaritetin shoqëror, dashurinë ndaj prindërve, miqve e ndaj njëri-tjetrit. Fëmijët lumturohen e gëzohen me dashurinë e prindërve të tyre. Në familje merret edukata e parë.”Edukata e mirë, është lulja e jetës”.

Mikpritja dhe bujaria, janë nga cilësitë më të mira që ka krijuar dhe edukuar familja shq-

Me emigrantët shqiptar në shtetin Helen

- NJË BISEDE NE AVION -



Dr. Nike Bunjaj,
Shkrimtar dhe Publicist

Mëngjes pranveror. Ishte data 20 prill... Në aeroportin e “Nenë Tereza” kishte mjaft njerëz që prisnin orën e nisjes së avionit, sipas linjave ndërkombëtare. Ishte ora e 06.00 mëngjesit. Petriti dhe Aleksandri, pasi u bene kontrollin e duhur doganieret, u nisen drejt avionit të linjës Rinas-Athine, pra drejt kryeqytetit helen. Hipën në avion, gjeten vendet e tyre sipas biletave, në rreshtin e katërt në të djathte, afër dritares. Petriti zuri vend i pari, afër dritares së avionit, kurse Aleksandri në karrigen e dyte, afër Petritit. -Mire na takoi këtu!- i thotë Petriti .

- Po, shume mire, s’ka më mire! – e pason Aleksandri.

Pas pak, një vajze e re, me origjine greke, u solli mëngjesin si gjithë të tjerëve. Më pas, ata po bënin biseda për punën dhe jetën në emigracion .

- Si shkoje kështu kjo puna jone si emigrant-te, - thotë Petriti, - me qindra e mijëra shqiptare u enden rrugëve të botes, natyrisht për një jete më të mire. Për qindra djem e vajza shqiptare, është për të ardhur mire, të cilët nderojnë familjen dhe Shqipërinë, atdheun e tyre të dashur me punën dhe sjelljet e tyre, ruajnë emrin e shqiptarit, që ka pasur kurdoherë. Ata, sot janë nder më të mirët emigrante në krahasim me të tjerë nga vende e kombësi të ndryshme .

Pra, dallojnë në shkollat ku mësojnë dhe kompanitë ku punojnë. Ata i dallon edhe atdhetarizmi në raport me emigrantet e vendeve të tjera. Në shtëpitë e shqiptareve valëvitet flamuri i kombit tone. Kjo është me të vërtete kënaqësi e madhe, apo jo Aleksandër?

-Kjo që thoni ju Petrit, është shume e vërtete, aq sa e vërtete është edhe ana tjetër negative e disa emigranteve të tjerë shqiptare, por që nuk përbejnë shumicën, të cilët vjellin vrer për vendlindjen e tyre, si p sh .. “Nuk duam të dëgjojmë për Shqipërinë”, kurse disa gra , kam dëgjuar që porosisin fëmijët e tyre kur shkojnë në skolle të mos tregojnë që janë shqiptare, apo fëmijëve nuk ua mësojnë asnjë fjale shqip! Kjo pra, tregon vetëm injorancën e këtyre emigranteve, të cilët nuk dëshirojnë ta quajnë veten me shqiptare. Këta njerëz, - vijoi Aleksandri , - nuk e di sesi i harrojnë fjalët apo shprehjet filozofike të Naim Frashrit, i cili shkruante në atë kohe nga mërgimi: *“Mëmëdhe quhet toka, / Aty ku më ka rënë koka”*. Apo Pashko Vasa po nga mërgimi: *“Shqiptare, mos shikoni kisha e xhamia, / Feja e shqiptarit është shqiptaria ...”*

Një shembull tjetër i kohës së sotme është shenjtëresha nenë e madhe, Nenë Tereza. Ajo punoi tere jetën e saj jashtë atdheut të vet, në kontinentin aziatik si bamirëse, por ajo nuk u shpreh asnjëherë se jam afrikane, indiane, greke, maqedonase apo serbe. Ajo kurrë nuk e mohoi prejardhjen, gjuhen dhe kombin e saj. Ajo shprehej kurdoherë e kudo se jam vetëm shqiptare. Këta, mund të ndjekin edhe një shembull tjetër, atë të bashkëkombësve të tyre në Greqi, të cilët pavarësisht nga racizmi dhe anti shqiptarizmi i theksuar atje, punojnë me nder e dinjitet në shoqërinë greke, duke mos e mohuar asnjëherë gjakun e prejardhjen e atyre Arbënore. Ata që duan, mund të ndjekin edhe shembullin e shtatëmbëdhjetë vjeçare, Maria Sharapona, që nga lartësia e Wimbeldonit

sikur u bën thirrje atyre paraardhësve të prindërve, motrave dhe vëllezërve të tyre për Shqipërinë. Të behet zemra mal kur dëgjojmë here pas here nëpërmjet medieve të shkruara dhe atyre vizive, që djem e vajza shqiptare dallohen neper shkollat e larta, mbarojnë studimet me rezultate të lara dhe marrin medalje ari dhe në fund prezantohen me dinjitet, se: “Jemi vetëm shqiptare” dhe dalin në foto para flamurit shqiptar. Kështu ndodh që nga SHBA-ja e kështu me radhe neper shkollat e Evropës: Itali, Gjermani, France, Poloni, Angli e të tjera. Populli shqiptar s’ka sesi mos të krenohet me këta bij dhe bija të tij, që po lëne gjurme të shkëlqyera atdhedashurie në mbare boten. Këta na bëjnë që të shfetojmë historinë dhe të kujtojmë rilindësit tanë si Jeronim De Radën, Pashko Vasën, Sami, Abdyl e Naim Frashrin e dhjetëra e dhjetëra të tjerë, të cilët megjithëse në emigrim, por për asnjë arsye nuk e harruan token e shtrenjte shqiptare, ku linden e u rriten, si nëpërmjet veprave letrare, përfaqësive diplomatike, gazetave, shoqatave politike e kulturore e të tjera. Janë këto arsye e shume të tjera që emrin e mire të shqiptarit, të atdheut vet, ta ngrëne deri në nivelet më të larta të historisë botërore. Kombi shqiptar ka qene, është dhe do të rroje në shekuj e brez pas brezi. Apo jo Petrit?

- Të dëgjova me shume vëmendje Aleksandër, dhe unë nuk i heq as pike as presje mendimit tënd.

Tani koha erdhi për të zbritur nga avioni . Ai kishte filluar të ule shpejtësinë dhe të filloje rrotullimin për të gjetur vendin e vet në aerodromin e Athinës. Petriti dhe Aleksandri zbresin nga avioni dhe me një taksi nisen në drejtim të lagjes Aneljosa, për të shkuar në shtëpitë e tyre.

Ditën e diele, me shume diell pranveror. Kryeqyteti i Greqisë, Athina, vend i bukur dhe piktoresk, Akropoli madhështor... Athina, qendra e Lashtësisë së kulturës botërore. Aty linden shkrimtare e filozofe me fame botërore: Aristoteli, filozof i Greqisë së Lashte, një nga mendimtarët më të mëdhenj të periudhës antike. Aristoteli jo vetëm sistemoi gjithçka pozitive të krijuar deri në atë kohe nga mendimi njerëzor, po dha dhe një kontribut të shquar në shume fusha të dijes, hodhi bazat e shkencës së logjikes e të tjera. Demokriti, filozof i Greqisë së Lashte, mendja e pare e enciklopedike midis grekeve. Epikuri, edhe ky filozof i shquar grek i periudhës helenizmit. Herakliti, filozof i shquar i Greqisë së Lashte, Platoni filozof e të tjerë....

Në qendër të Athinës, ndodhet një lokal i madh, prone e një shqiptari. Aty mblidheshin here pas here emigrantët shqiptare gjate ditëve të pushimit. Madje, greket e quanin “Klubi i shqiptareve”... Edhe atë të diel, ky lokal kishte grumbulluar mjaftë emigrante shqiptare. Grupe shokësh, në çdo tavoline. Dikush pinte kafe, një tjetër grup kishte mbushur tavolinën me shishe birre, dikush pije freskuese. Pra, çdo gjë sipas dëshirës, kishte nga ata që pinin ndonjë gote uiski të përzier me Koka-Kola.

Agroni, emigrant nga Shkodra, kishte zënë vend në një tavoline gati në qendër të lokalit. Ai po tregonte një ngjarje tragjike:

-Para dy vitesh , erdha ne Greqi si emigrant ilegal, bjeshkëve e pyjeve pafund, rruge e pa rruge. Ishim gjashte shoke, Jani nga Vlora, Agimi nga Tirana, Marku nga Lezha, Pjetri nga Puka dhe Kujtimi nga Gjirokastra. Na bashkoi kënga popullore !- dhe qeshi.

-Me harrove dhe mua, -i tha Zefi, - nga Malësia e Madhe. Kemi qene bashke.

-Po, - thotë Agroni, - harrova për momentin. Ti, madje ishe me i shkathëti për të ecur neper bore dhe na hapje rrugën. Erdhëm ilegalisht, meqë vize nuk na dha konsullata greke. Dy here kam bere kërkesë dhe asgjë. Ndaj u detyruam të marrim rrugën e rrezikshme për të ardhur këtu në Greqi.

Në Gjirokastër qëndruam tre dite për t’u bashkuar. Kujtimi e dinte fare mire vendin ku do të kalonim kufirin. Ishte një nate shkurti me shi, ere dhe në disa vende me bore. Rrugën na e udhëhiqte Kujtimi, - vazhdon të tregojë Agroni, - shiu i ftohte me ere nuk pushonte për asnjë moment. Neve na dukej, se edhe ai po na bënte për inat. Binte bore me shi bashke i bere ‘turlu’. Pas gjashte orësh udhëtim të mendueshëm, u ndalem për të pushuar dhe për të ngrëne pak buke. Kishte filluar të zbardhte dita. Po edhe ajo e shkrete buke ishte lagur e ishte bere paçamur... U ngritëm dhe përsëri vijua rrugën. Kujtimi, para si gjithnjë. Pas pak ai ndalet dhe shikon diçka djathtas. U afruan dhe ne të tjerët. Çfarë të shikonim? Shtate kufoma njerëzish të shkrirë, vetëm skeleti u kishte mbetur. U tmerruam sa s’ka ku të shkonte ndryshe. I shikuam me kujdes. Ndoshta ndonjë dite, edhe neve ky fat do të na prese, shtoi Zefi. Emigrante, tha Marku, janë ngrire nga të ftohtët. Mjere familjet e tyre! Ata mendojnë se janë në Greqi për t’u fituar bukën e gojës, kurse këta nuk jetojnë më. Ndoshta i kane vrare dikush për t’i grabitur, shtoi Kujtimi. Raste të tilla kane ndodhur me dhjetëra emigrante që janë zhdukur pa lëne gjurme... Nuk është e mundur që të kenë vdekur të gjithë nga të ftohtët, por shumica nga plumbat e krimineleve për tu grabitur paratë që kane fituar me gjak e djerse.

E duke shikuar rreth e rrotull kufomave, Petriti tha: Ja ku janë tri gëzhjoja automatiku, pak më tej edhe dy të tjera, shtoi Agroni. Pjetri kishte marre një kafe në dore dhe duke shikuar, dallon shume qarte vrimat e plumbave në koke. Pra, kjo vërteton plotësisht se këta të mjere janë ekzekutuar nga dora e krimineleve mafioze. Ja edhe kafkat e tjera, ja ku i kane vrimat e plumbave! Të gjithë në koke i kane qëlluar të mallkuarit.

Afrohet Jani dhe i shikon me kujdes dhe fillon t’i rrjedhin lot nga sytë. Ai, pastaj fillon të nervozohet dhe shton: Si është mundur që nuk vret Zoti në vend këta kriminele të pa shpirtë, që bëjnë kështu, krime makabre? Do t’i vrase, do t’i vrase Zoti, tha Agroni. Një dite edhe ata do t’i lëne rreshtat e kokës. Ketë krim të shëmtuar dhe shume krime te tjera, qe duhet të kenë bere, duhet t’i paguajnë, por e keqja më e madhe qëndron se njerëzit qe kane vrare nuk ringjallen më.

Gjashte shokët emigrante, pas një ore që qëndruan pranë shokëve të tyre emigrante, e ngrire nga të ftohtit e të stresuar nga ngjarja makabre që panë, me koke te ulur dhe me dhimbje në shpirt, vijuan përsëri rrugën...

BANDA E KRIMINELEVE GREKE QE GRABISTE DHE PASTAJ VRISTE EMIGRANTET SHQIPTARE

Aleksandri, njeri nga emigrantet e pare që ka emigruar në Greqi që në viti 1991, i cili punon dhe jeton atje, është edhe zv. kryetar i shoqatës “Për mbrojtën e të drejtave të emigranteve shqiptare”, atë dite shtatori ndodhej i mërzhitur shume. Kishte marre vesh një ngjarje të hidhur, që kishte ndodhur vite më pare, por që ishte zbuluar ato dite, për të cilën kishte marre informacion nga mediet e shkruara dhe ato vizive greke. Merr në telefon një mikun e vet:

- Andon, meqë keni pushim sot, hajde pak nga shtëpia ime, se kam një pune me ty.

- Mire Aleksandër, - i thotë ai, - në moment po vij, vetëm sa të më beje rruga.

Pasi pine kafe, Sandri dhe Andoni filluan bisedën rreth ngjarjes së bujshme të ndodhur në zonën e Selanikut, për vrasjen e disa emigranteve shqiptare atje kohe më pare.

- Do vish ti Andon me mua, se dua të takoj një të njohurin tim, është kryepolic dhe kam shume dëshirë për të marre një informacion të sakte për ngjarjen. Më duhet edhe për shoqatën.

- Mire, - thotë Andoni, - shkojmë bashke.

- Po marrim me vete dhe një shok timin, gazetar shqiptar, me banim këtu në Athine, Zamir e quajnë, tha Aleksandri. Pasi morën kontakt me policin M. S, i cili i prit me dashamirësi dhe u angazhua sinqerisht për t’u dhenë informacionin e kërkuar lidhur me ngjarjet e renda kriminale nga disa shtetas greke ndaj emigranteve shqiptare, në zonën e Selanikut dhe të Janinës.

Kryepolici M. S., u sqaroi të pranishmeve, se: “Është zbuluar vërtet një bande kriminale greke në kohet e fundit, e cila ka vrare disa emigrante shqiptare gjate harkut kohore që nga viti 1995 e më vone. Është një pronar nga zona e Selanikut, i cili ka vrare disa emigrante shqiptare në ketë hark kohore e më vone. Një pronar nga zona e Selanikut, i cili punonte edhe si taksist, Janise Baltas quhet, bashke me të vëllanë e tij polic Stavro Baltas, në bashkëpunim edhe me mikun e tyre Dhimitris Savelidhi, kohe më pare kane vrare dy emigrante shqiptare, të cilët quhen P. Ll dhe P. L. Mendohet, se kjo bande”, vazhdoi ai, “ka vrare edhe zhdukur edhe dhjetëra emigrante të tjerë shqiptare, të cilët pasi kane grabitur, i kane vrare dhe u kane marre paratë e gjerat e tjera të çmuara dhe pastaj i kane zhdukur, me qellim për të mbuluar gjurmët e krimit. Arrestimi i këtij grupi kriminal, po hedh drite në mënyrë më konkrete për vrasjet dhe zhdukjen e shume shqiptareve të tjerë. Pra, tre personat e arrestuar janë autoret e padiskutueshëm të vrasjeve te emigranteve shqiptare e të tjerë gjate këtyre dhjete viteve të fundit. Ky grup”, vijoni kryepolici grek, “ akuzohet edhe për zhdukjen e tri vajzave të reja. Policia jone, në bashkëpunim edhe me policinë shqiptare ka hapur dosjet e vrasjeve që nga viti 1995, dhe me këto që janë zbuluar kohet e fundit, sidomos në zonën e Selanikut dhe të Janinës. Kemi gjetur vendin dhe kufomat e dekompozua, në një shesh të vogël, në mes të një pylli në zonën e Selanikut. Shumicën e këtyre të vrare e ka pohuar grupi kriminal edhe në sallën e gjyqit, i kryesuar nga Janis Baltos me të vëllanë polic dhe me mikun e tij Dhimitris Savelidhi. Shkak për të bere ketë zbulim, u bë vrasja e dy emigranteve shqiptare të vrare kohet e fundit, ku ata vranë edhe një grek. “Pasi ishim grindur me dy emigrante shqiptare”, tregon para prokurorisë Janis Baltas, u pagova paratë dhe pastaj menjëherë me Stravon e Sovolidhin, vendosem t’i vrasim. Morëm armët dhe hapem zjarr të tre njëkohësisht. Njeri prej tyre nuk vdiq menjëherë. Pastaj e qëllova edhe një here tjetër nga afër. Më pas u morëm paratë e tyre që u kisha paguar dhe i varrosem trupat e tyre. Në fshat hapem fjale, se dy emigrante shqiptare ikën në atdheun e tyre”.

Kështu e ka përshkruar P. Ll e P. L”, vazhdon kryepolici greke M. S.

Aleksandri, gazetari dhe Andoni, largohen nga zyra e kryepolicit M. S., duke e falënderuar për zemërsisht për informacionin e dhënë dhe pritjen me shume për zemërsi.

MARASH KOLA

NJË JETË TË TËRË NË SHËRBBIM TË ATDHEUT

- NË 85 VJETORIN E LINDJES -

Mirënjohje për të gjitha ata kuadro e punonjës të ndryshëm, bijë e bija të Dukagjinit, të cilët me zotësi, me dijë e kulturë, me ndërgjegje dhe përkushtim të spikatur, kanë punuar e punojnë për të naltësuar përsonalitetin e tyre, dhe emrin e mirë si dukagjinas që gëzojnë.

Respekt e mirënjohje edhe për shoqatën e gazetën tonë për punën që ka bërë në njohjen e këtyre figurave si model për brezin e ri, për sot dhe për të ardhmen, që ia zbardhin faqen vendlindjes së tyre, kudo ku punojnë dhe jetojnë.

Është e lavdërueshme iniciativa e Degës së Tiranës, e cila në një vëllim të veçantë na ka dhënë portretin e disa përsonaliteteve dukagjinas që kanë punuar e punojnë në Tiranë.

Në këtë shkrim, po veçojmë njërin prej tyre, më jetëgjatën, e ky është Marash Kola, birë i shquar i Lotave, i cili para disa ditësh festoi 85 vjetorin e lindjes. Për afro 70 vjet i ra kryq e tërthorë, anë e mbanë atdheut, pa u lodhur, gjithnjë në lëvizje, gjithnjë midis njerzëvë të thjeshtë, nga veriu në jug, gjithnjë me krenari të ligjshme që është dukagjinas. Ai është njeri që ka lënë gjurmë të pashlyeshme, jo vetëm në fshatin e tij, por në çdo fshat të Dukagjinit, e për të vazhduar në fshatra e qytete, si në Pukë, në Dibër, në Gjirokastrë, në Korçë, e së fundmi në Tiranë ku dhe jeton.

Ndonëse u largua në moshën 24 vjeçare nga Dukagjini, asnjëherë snjëherë nuk i shkëputi lidhjet me vendlindjen, me fshatin e tij të dashur, jo vetëm kur kishte gjallë prindërit, por edhe pas largimit të tyre nga jeta, është kthyer vazhdimisht për të takuar njerëzit e afërt, shokët e miqtë, kudo në Dukagjin. Në dy librat e botuara “Dashuri e mall për Dukagjinin” si dhe “Udhëtim në vite”, i gjrjmë të derdhura me mjeshtri këto ndjenja të fuqishme të autorit, mall e dashuri, respekt e mirënjohje të pashuar.

Marashi u lind me 13 korrik 1931, në një familje me tradita atdhetare. U rritë me dashuri për njerëzit, për punën, për dijen, për të vërtetën. Edimi i shëndoshë familjar, zgjuarësia natyrore, e vunë atë në kërkim dhe gjetjes së rrugëve më të mundshme për ti shërbyer atdheut. Ai, ndonëse në moshë të re, përcaktoi objektiva të qarta për të ardhmen, duke filluar nga shkollimi i tij. Me vullnet të paparë mësoi shkrim e këndim, si autodidaktë, në rrasa guri e copa letre, dritën e pishës dhe të kandilit, natën e ditën, deri sa dha edhe provimet për klasën e katërt shkollës fillore. Është koha, janë vitet e para pas çlirimit, rruga e zgjedhur kërkonte dije dhe kulturë. Vendi po mjekonte plagët e luftës, po rimbëkëmbej, e për këtë u

ngrit në këmbë rinia, si kudo edhe në



Dukagjin, duke u hedhur në aksione zinxhir, ia filluar me kanalët e para vaditësee më tej, për ndërtimin e rrugëve të hekurta të atdheut. Në këto aksione Marash Kola ishte në ballë, si përgjegjës i rinisë dukagjinase, ndonëse në moshën 17 vjeçare. Në gjoksin e tij dhe të brigadave vullnetare shëndrisnin simbolet e punës, gjithnjë pararojë, gjithnjë në vend nderi, në të gjitha aksionet deri në rrugën e Malësisë së Madhe, ku rinia e Dukagjinit i kthej në traditë aksionin, fitoren.

Marashi, çdo ditë e më shumë, shfaqti dëshirë e vullnet për më tej, prandaj ju fut shkollës 7 vjeçare pa shkëputje nga puna, duke embaruar në kohë rekord, në kushte mjaftë të vështira, duke qenë edhe në punë, edhe në aksione, por shkollës nuk iu nda. Duke parë pasionin dhe vullnetin e tij, dëshirën e tij për dije e shkollim, organet përkatëse e emrojnë në sektorin e edukimit për ish rrethin e Dukagjinit, e më vonë në rrethin e Pukës, prej këndeje përfundon arsimin e mesëm, duke dhënë një shembull të admirueshëm për çdo njeri, se çfarë energjishë çlirohen kur ka ide dhe qëllime të larta. Pikërisht në Pukë u pa kapaciteti i Marashit, e për këtë organet përkatëse vendosën që ai të ulej për herë të parë në bankat e shkollës, duke e dërguar për studime të larta në shkollën e diplomacisë në Moskë. Marashi, në Moskë, me një përkushtim të madh, me vullnet të fortë, për dy vjet qëndroi atje, mësoi gjuhën rusë edhe gjuhën e dytë, duke siguruar rezultate të shkëlqyera.

Prishja e marrëdhënieve me ish Bashkimin Sovjetik çoi në ndërprerjen dhe kthimin në atdhe të të gjithë studentëve që studionin atje. Edhe Marashi u kthye, poe angazhimin për të çuar deri në fund ambicjen e tij duke dhënë provimet e vitit të tretë duke suguruar rezultate shumë të mira. Natyrisht që nuk mori fund shkollimi i Marashit. Po, pa shkëputje nga puna mbaroi shkollën e lartë të filozofisë, dhe kur shkoj më punë në Gjirokastrë e mbydhi betejën e shkollimit të tij, duke mbaruar Institutin e Lartë Pedagogjik, si gjithnjë me rezultate shembullore në moshën 41 vjeçare, kështu ai realizoi atë që thoshte Nënë Tereza: “Pas çdo vijë mbërritjeje është një vijë nisë”.

Edhe në jetën familjare e shoqërore, Marash Kola, në të gjitha detyrat që i takonin dhe që ju ngarkuan, ishte prezent kurdo herë me prezencë, me mendime dhe veprime. Ai është formuar me një dashuri të madhe për njerëzit dhe punën, duke realizuar një komunikim njerzorë më të gjithë, duke folur me kulturë, duke dëgjuar me rëspëkt e dashamirësi ata. Në këtë mënyrë ai tregon fisnikërinë e tij, e cila është barrë e rëndë për çdo njeri. Ai ka mbjedhur kudo dhe kurdoherë dashuri, mirëkuptim, tolerancë, afim, midis njerëzve. Marashi nuk e ka plagosë krenarinë e tjetrit edhe kur natyra e punës binte ndesh me qëndrime e veprime që edhe mund të ndëshkoheshin.

Thjeshtësia e tij i bën për vete njerëzit. Asnjëherë nuk bërtiste, nuk kërcënonte në emër të detyrës që kishte.

Marashi, si njeri i fortë dhe me karakter të pa lëkundur ka ditur të qëllimisë hidhërimin, kur është ndeshur me ngjarje, me humbjen të njerëzve të dashur, të shokëve kur kanë pasur fatëkeqësi, të miqëve, të bashkëfshatarëve e bashkëqytetarëve. Drejtpeshimi dhe natyra e tij, edhe sot, në këtë moshë, shpreh solidaritet të plotë me ta, duke i përprahur e dhënë kurajo. Ai është i pranishëm në këso rastesh, prandaj njerëzit pyesin: “a erdhi Marash Kola”, me dëshirën për ta takuar dhe për tu çmallur me të. Ai qëlliti hidhërimin që i shkatoi “genocidi” i sajuar për të, duke e izoluar për 17 muaj dera sa fitoj pafajsinë. Këtu duhet të veçojmë jo vetëm qëndrimin e tij burror, por edhe solidaritetin jo vetëm të njerëzve të tij, por, të dhjetra e dhjetra shokëve, miqëve dhe dashamirëve nga jugu në veri.

Ato çfarë u thanë më lartë për Marashin janë vetëm një pjesë e atyre vlerave që ka ky dukagjinas i nderuar, duke rrezatuar kudo e kurdoherë mirësi.

Edhe shokët e tij të punës e vlerësojnë

shumë lartë Marash Kolën. Publicisti i mirënjohur Sevo Tarifa shkruan: “E njoha për herë të parë në Gjirokastrë. Ishte viti 1968. Një burrë i gjatë, shtatlartë,, trupdrejtë, fytyrëqeshur, symprehtë, vetulltrashë,. Ecte më hap të rregullt në Sheshin “Çerçiz Topulli”. Sa e pashë më bëri përshtypje. Nuk më dukej gjirokastërit. Pyeta Mudeirin që kisha pranë se kush ishte ky burrë që po kalonte. Është Marash Kola – dukagjinas. Ka ardhur me punë këtu në Gjirokastrë. Është burrë malësie. Do keshë rast ta njohësh sa burrë i mirë është”. Sevoja e shfrytëzon rastin për të folur jo vetëm për Marashin, por edhe për Dukagjinin, si mikëpritës e bujar, që i zgjuan kujtimet e kohës kur Sevoja kishte kaluar gjatë luftës në zonën e Dukagjinit.

Profesor Muharrem Kushe shkruan “Ndjenjat e tij patriotike dhe atdhetare e vendosin Marashin në një vend të veçantë për të gjithë ata që kanë punuar me të, për miqtë e tij të vjetër e të rinjë, duke qenë edhe unë një nga ata”.

Shoku i vjetër i punës Reshat Leskaj, duke folur për Marashin dhe librin e tij “Dashuri dhe mall për Dukagjinin” shkruan: “Ky libër është dhuratë jo vetëm për fëmijët e tu, të cilët në çdo kohë ndjehen krenar për babanë e tyre, me cilësi dhe virtyte të larta, por edhe për shokët e tu”.

Marashi kudo dhe kurdoherë u vu në kërkim të vlerave njerëzore tek bashkëfshatarët e tij, tek njerëzit e thjeshtë të fshatit dhe qytetit, tek kolegët e punës, tek vartësit e eprorët e tij. Ato i ka derdhur me mjeshtri në librat dhe shkrmet e tij që nga viti 1954 e në vazhdim në shtypin e kohës, me një problematikë të gjerë aktuale dhe për ditët e sotme.

“Arkivi” është aq i pasur sa mund të shkruaj edhe vëllime të tëra me të njëjtin titull “Dashuri e mall për Pukën, për Dibër, për Gjirokastrën, për Korçën, për studentët, etj etj.

Të shkruaj për Marash Kolën nuk e kisha të lehtë, përkudrazi, u mendova shumë, bisedova edhe me shokë e miq që të mund të jap sa më mirë portretin, një pjesë të jetës, punës, dashurisë së ndërsjelltë për njerëzit dhe me njerëzit, që i tashëgoj dhe i ruajtën që nga lindja. Marash Kola ishte dhe mbetet i veçantë, model i sakrificës, dhe i sfidave për tu bërë ai që është, i dashur, i respektuar, i nevojshëm për njerëzit.

Në mbydhje, për 85 vjetorin e lindjes i urojmë shëndet të plotë, jetë të gjatë, lumturi në jetë si stërgjysh bashkë bashkëshorten e tij, Lenën, si dhe djemtë, nipat e mbësas, me shokë e miq të shumtë që bashkohen më mua në këtë urim.

ND OC GRIMAJ

DUKAGJINI SHUMË I BUKUR, POR MALËSORËT E KËTIJ VENDI MË TË BUKUR KANË SHPIRTIN

- BASHKËBISEDIM ME ZYLI KRAJËN -

Rasti e solli që një ditë në këtë pranverë, bashkë me time shoqe, të gjendemi në klinikën e Dr. Besim Kraja për të vizituar dhëmbët. Gjetëm një njeri shumë të përgjegjshëm, i qetë, me një klinikë mjaftë të mirë dhe disa njerëz në radhë për punët e tyre. Kur ne u futëm brenda ishte buzëqeshja që në pritë e para. U përshëndetëm dhe pa filluar që të bisedonim për dhëmbët, ra bisedë se nga ishim ne. Kur i përmendëm emrin Dukagjin, u ndal dhe tha: Baba im, Ramadan Kraja, ka punuar dikur në Dukagjin dhe gjithmonë ka ruajtur respektin më të madh për atë vend dhe ata banorë. Unë e kisha dëgjuar shumë kohë përpara këtë emër, për të cilin flisnin me shumë respekt kushdo, kur binte fjala për të. Nga që kishte përsëri pacient që po prisnin, e ndërpremë bisedën për ta vazhduar një ditë tjetër.

Shkova dhe e takova përsëri, Dr. Besimin. Nuk kishte njerëz që të prisnin sepse shkova disi vonë qëllimisht.

Në qendër të bisedës këtë radhë u vu një takim që Besimi kishte pasur më një malësorë dukagjinas disa kohë më parë, të cilën po e përshkruaj shkurt.

“Punoja në klinikë, fillon të flasë Besimi. Një ditë, para pak vitesh më vjen këtu një malësor i pashëm, i mbajtur dhe filloj të më pyes me shumë kujdes se kush isha dhe a kisha lidhje më Ramadan Krajën. Unë nuk e njihja aspak se kush ishte, por i them pa asnjë droje, po, ai është baba im. Unë thotë ai, quhem Lin Guri, ose Lin Deda nga Brashta e Shoshit, dhe vazhdoi: ti e ke vendin gjithmonë në krye të vendit në shtëpinë time. Lini e ndërpreu bisedën dhe u mbush disi me frymë.

-Nuk po kuptoj ndonjë gja i thash unë, tregon Besimi. Atëherë Lini filloi dhe tregoi si ishte puna.

- Mua, thotë ai, më kanë pushkatuar babën fillë pas çlirimit të vendit. Kemi qenë shumë fëmijë dhe mbetëm jetimë. Ishim shumë në varfëri, por edhe ma keq sepse rrezikoheshim nga uria. S’kishte kush të punonte, nuk kishim përkrahje sepse baba ynë kishte qenë kundër sistemit që u vendos. Në këtë gjendje nana ime, vendosi të shkojnë dhe ti kërkojnë ndihmë Kryetarit të Lokalitetit, që ishte Ramadan Kraja, pra baba yt. Ajo shkon, Ramadan Kraja e pret dhe e dëgjon me kujdes. Ajo i paraqet gjendjen ekonomike siç ishte, sepse për nga ana politike sigurisht që e dinte. Pasi e marrë vesh me shumë kujdes, i jep një letër që të trajtohej me ndihma ushqimore në mënyrë të plotë dhe rregullisht deri si të rriten fëmijët dhe të bahen të zotët e vetit. Ashtu u ba. Për këtë gjithmonë do të kujtojmë këtë veprim të Ramadan Krajës, por dhe ju familjarisht.”

Ishte një tregim i shkurtër, por shumë i thellë, që dëgjova nga mjeku stomatolog Basim Kraja, të cilit i ishin ngulitur thellë në ndërgjegjen e tij. Ajo ngjarje kishte mbi 60 vjet që kishin ndodhur, por që

edhe malësori Lin e kujtonte me respekt.

Kjo më shtyri që të shkojmë në shtëpinë e Besimit dhe të takojmë nënën e tij e të bashkëbisedojmë pak minuta me të. Ishte shumë e gjallë, ndonëse kishte kaluar të 82 vitet, e mbajtur, dashamirëse, mikëpritese dhe me një kujtesë shumë të mirë.

1. Kur shkua në Dukagjin dhe sa kohë qëndruat atje. Ku u vendosët për të jetuar. Po bashkëshorti juaj ku e kishte zyrën e punës. Si e prit bashkëshorti dhe ju shkuarjen në Dukagjin.

Me 7 maj jemi martuar dhe me 9 maj kemi shkuar në Dukagjin, kam kënë 19 vjeçe, sot jam 82, bëje vetë llogarinë kur kemi shkuar në Dukagjin atëherë. Kemi fjetë në Prekal dhe të nesërmën kemi arritur në Breglumi. Fillimisht jemi vendosur në zyrën e Ramadanit. Ditën ishte zyre punë, natën ishte dhomë fjetjeje. Unë e mora me pak përtesë, ndërsa Ramadan jo, sepse kishte qenë edhe më parë atje me punë dhe i njihte malësorët, ishte miqësor me ta dhe kishte fituar respektin e tyre.

Më vonë na bënë disa banesa për tu sistemuar ata që kishin ardhur nga zona të tjera për të punuar në Dukagjin. Në njërin nga ato na sistemuan edhe ne, ku qëndruam për 8 vjet. Bashkëshorti im zyrën e punës e kishte afër me shtëpinë, në Breglumi të Shalës. Shkuarjen në Dukagjin bashkëshorti im e prit shumë mirë, ndonëse, unë, në fillim nuk e prita fort mirë nga që kishim vetëm tri ditë të martuar dhe isha e re.



Zyli Kraja dhe Age Gila

2. Si ndjehej bashkëshorti juan gjatë punës në Dukagjin.

Bashkëshorti im ndjehej shumë mirë me punën dhe njerëzit që e rrethonin. Ndjehej si në shtëpinë e vet.

3. A kujtoni ndonjë nga bashkëpunëtorët e bashkëshortit tuaj, qofshin këta nga Dukagjini apo edhe nga jashti tij që punonin në Dukagjin?

Mosha dhe koha bën të vetën, por nuk mund të harroj Kolë Noshin, Todi Prifti, Jovan Thimi, Martin Gjoni, Kolë Vata, Nikë Gjoni, Zef Hajdari, Mirash Zefi, Fuat Beqja. Ndërsa nga gratë kujtoj Agen e Martin Gjunit, Shuken e Mirash Zefit, por kishim shumë miqësi me grupin e mjekëve dhe infermiereve që në atë kohë punonin në Breglumi.



Ne familjen e Mirash Zefit në Breglumi 1958

4. Sipas mendimit, tuaj si e gjetët Dukagjinin në pikpamjen ekonomike, si ju pritën ju.

Në atë kohë kishte varfëri. Gjendja ekonomike ishte shumë e dobtë, por kishin mikëpritje. Njerëzit ishin shumë bujarë. Ata janë të gjithë shumë mikpritës, por kujtoj familjen e Mirash Zefit dhe Martin Gjunit, me të cilët kemi pasur më shumë afërsi.

Natën e parë që fjeta në Dukagjin ishte në Prekal. Pashë fukarallëk të madhe por, njerëzit, kudo, ishin të çiltër, të qeshur dhe shumë zemërbardhë. Kemi fjetur në fier dhe kami pas për ndriçim vetëm pishën. Në dukagjin jemi trajtuar me shumë respekt nga të gjithë.

5. Jeta juaj familjare në Dukagjin, lindjet e fëmijëve, vështirësitë ekonomike.

Jeta imë familjare, në Dukagjin, ishte si e të gjithëve pak a shumë. Pas dy viteve lindëm një djalë. Ai nuk jetoi vetëm 4 muaj. Vdiq në një ditë shumë të egër dimëri dhe bore të jashtëzakonshme për ato zona. Ishtë e pamundur përcjedhja për ta varrosur në Shkodër dhe u detyruam ta varrosim në një kodër sipër shtëpisë ku banonim. Nuk ja mbaj mend emrin asaj kodre (Kodra e Bungajës). Ishte një humbje shumë e madhe për ne. Më vonë lindëm një vajzë e cila mbajti përgjithmonë vendlindjen Dukagjin.

Ishim mirë, nuk njohëm vështirësi shoqërore. Vdekja e djalit na shqetësoj jashtëzakonisht shumë, por në ato ditë të vështira na u gjendën afër shumë malësorë dukagjinas të cilët na ngushëllonin dhe na muarën një pjesë të mërzitjes që kishim, na e lehtësuan dhimbjen. E varrosem në një kodër, jo larg shtëpisë, rrëzë një gështenje.



Dukagjin, 25.2.1958. Në këmbë nga e majta Alush Nurja, Ramadan Kraja, Kolë Noshi, Prelë Grimaj.

6. Lidhjet familjare me malësorët e Dukagjinit dhe sa ruhen në kujtimet tuaja ajo kohë

Lidhjet me malësorët i kemi pasur të jashtëzakonshme dhe i kemi ruajtur vazhdimisht. Kujtoj me madhë vizitat, drekat dhe darkat që kemi kaluar bashkë në familjet malësore. Jam 82 vjeçe dhe i kujtoj me shumë respekt, por u a kam treguar edhe fëmijëve.

Përpiqemi për ti ruajtur dhe për ta kujtuar atë kohë, ishte jo e lehtë por ishte shumë dashamirëse, ishte e bukur, mësuam shumë edhe ne nga puna dhe jeta në ato vende të bukura. Nuk besoj kurrën e kurrës se ata malësorë të jenë ashtu siç dëgjoj nganjëherë nëpër televizione. Ata për ne kanë qenë shumë të mirë, shumë të sinqertë dhe shumë të gjendur për çdo nevojë që kishim ne, por, i shihsha edhe për ndihmën ndaj njëri tjetrit në rastë të veçanta dhe të vështira.

Disa vite kemi dalur në Theth për të kaluar verën. Vinte edhe Ramadan. Kemi qëndruar në shtëpinë e Shpend Sokolit, nuk e mbaj mend lagjen (Nikgjonaj). Ishte një familje shumë e pritun, shumë dashamirëse dhe sjellshme jo vetëm me ne, por me këdo që takoheshin apo vinin për vizitë në shtëpinë e tij. Shpendi ishte një burrë në moshë, por i zgjuar, me mustaqe të gjata, mbante kapuçin e bardhe dhe një shami të bardhë që mbështillej rreth kokës. Ishte fjalë pak por mjaftë i mëçëm.

Kam udhëtuar me dukagjinas nga Breglumi deri në Shkodër dhe me kanë ndihmuar dhe përcjellur si motrën e vet.



Në Theth

7. A kujtoni momente të veçanta të vështirësive dhe mënyrën e përballimit të tyre, qofshin ekonomike apo të ndonjë natyre tjetër.

Momenti më i vashtirë për ne ishte vdekja e djalit, rrugët ishin të zanuna nga bora e madhe dhe të ftohtit dhe nuk arritëm të transportonim për në Shkodër.

Banorët na qëndruan afër dhe në ndihmuan për kalimin e kësaj dhimbje. Problemet që na dilnin i kalonim si gjithë të tjerët. Nuk kishte dallime në mes nesh dhe banorëve vendas.

8. Jeta juaj familjare pas largimit nga Dukagjini, por edhe pas largimit të bashkëshortit tuaj nga kjo jeta. A është transmetuar tek fëmijët tuaj ajo kohë që ju keni jetuar në Dukagjin, me të mirat dhe vështirësitë.

Pas 8 vitesh punë në Dukagjin, bashkëshorti im, transferohet me punë në Shkodër. Unë qëndrova në qytet, në ato punë që mund të bënim. Lindëm fëmijë të cilët i shkolluam sipas mundësive. Një vajzë u diplomua mjeke, ndërsa djali u diplomua mjek stomatolog. Kam një familje shumë të mirë dhe shumë harmonike. Moshë e bën punën e vet por unë ndjem shumë mirë në familjen time. Më vjen keq për Ramadanin që aksidentalisht u nda nga jeta 65 vjeç.

Dua të kujtoj këtu se në fillim të viteve '70, një vajzë e imja shfaq dëshirën për të shkuar vullnetare në zonat e thella malore. Rasti e solli që ajo të shkonte në Dukagjin ku qëndroj 1 vit në fshatin Abat të Shalës. Kur e mbylli atë aksion, e pyeta se cilat ishin përshtypjet e saj nga puna dhe jeta në Dukagjin. Ajo përgjigjet me shumë dëshirë se ishin vende të bukura, që mund të zhvillohen, por më të bukur këta malësorë kishin shpirtin, besnikërinë dhe bujarinë.

Ndarja nga jeta e Ramadanit ishte e



vështirë shumë për mua dhe familjen tonë, por jam e kënaqur për Besimin, djalin tim, dhe familjen e tij, vajzat e martuara dhe të rregulluara mire dhe që i kam shumë të mirë dhe shumë të sjellshëm. Kudo dëgjoj fjalë shumë të mira për ta, e mua më bëhet zemra mal, më shtojnë jetë.

9. Po ndodhë që për shumë gjëra negative, gishti drejtohet nga dukagjinasi. A mund të na thoni ndonjë mendim

tuaj në duke pasur parasyshtë përvojën tuaj nga jeta në Dukagjin.

Po, kam dëgjuar sidomos para disa viteve sepse tash janë shumë më të radha. Unë jam e bindur se nuk është kështu. Natyrisht ka njerëz kudo që bëjnë veprime të pa mira, po ka edhe kriminel, por dëshira për të damkosur banorët dukagjinasi, them unë, bëhet për të larguar përgjegjësitë e për tua hedhur të tjerëve. Unë them me vete, se si është e mundur

që të ndryshojnë këta njerëz kështu, por asnjë herë nuk e besoj sepse kam jetuar shumë vetë atje dhe i njoh shumë mirë.

10. Gjatë qëndrimit në dukagjin, a diskutoheshin në familjen tuaj problemet e krahinës, midis jush apo edhe midis miqësh kur vinin tek apo kur ju shkonit te të tjerët.

Në atë kohë, në familjen tonë, por besoj se edhe na familjet e tjera të kuadrove që drejtonin në Dukagjin, apo edhe në vende të tjera, punët e shtetit nuk bëheshin pazare në familje apo grupe familjare. Po, trajtoheshin nevojat e përgjithshme, vështirësitë e shumta që ishin. Diskutohej edhe për mënyra se si mund të kalohehin. Asnjëherë nuk diskutohej me emra të veçantë. Unë kisha punët e shtëpisë, fëmijëve dhe nuk hyja farë në këso bisedash.

11. Ishte kënaqësi dhe ju falnderoj, zonja Zyli, për gjithë sa biseduam bashkë.

Jo, faleminderit ju, por me që mu dha rasti, dua tu dërgoj nëpërmes gazetës tuaj, përsëritje shumë të përzemerta të gjithë dukagjinasi kudo që janë dhe tju them faleminderit për gjithë respektin që keni treguar ndaj familjes tonë në ato kohë të vështira, por edhe gjatë gjithë jetës.

**Bashkëbisedoi
Luigj SHYTI**

Mhill Pali, një intelektual i Gjuraive, që rrit vlerat e Dukagjinit

Një burrë e qeshur, goje ëmbël, kompetent në ato që diskuton, sfidant i kohës dhe i moshës ... Kështu do ta cilësoja Mhill Pain, komandantin siç e thërrasin të gjithë.

Mendoj, që këtyre figurave ju a kemi pasur borxh me kohe të pasqyrojmë vlerat e tyre për nderin, që i bëjnë, me një kontribut të shkëlqyer fshatit të tyre të lindjes, Gjuraive, i cili është krenar për të tillë bij, por edhe më gjere- Dukagjini dhe shoqëria, që e njohën dhe patën marrëdhënie pune e shoqërie me te.

Unë e kam njohur komandantin në një moment kur ai mund të tregohej ndaj meje mosmirënjohës dhe nënvleftësues për vete pozicionin që kishim, parësish, që unë vijoja shkollën e lartë, por ai u tregua gjithnjë i dashur dhe mësuës shembullor për mua, duke më pare me një qëndrim tepër fisnik.

E bëra këtë prezantim paraprak, për të portretizuar pak figurën e Mhill Palit.

Mhill Pali lindi me 16 janar 1944, në katundin (lagja) Gjuraaj, sot fshati Gjuraaj. Kur Mhilli ishte në moshën 6 vjeçare, familja e



tij u vendos në fshatin Rrash-Kullaj, të Gruemires. Aty përfundon me rezultate shumë të mira, shkollën 7 vjeçare. Ashtu, si të gjithë bijtë e familjeve dukagjinase, u rritë me vështirësi të mëdha ekonomike, por kjo gjendje nuk mundi të ndal vullnetin e tij për tu arsimuar deri në nivelet më të larta.

Ai, pasi përfundoi shkollën e mesme, pasi kishte pasion për tu bërë ushtarak, në vitin 1961 u regjistrua në Shkollën e Oficerëve në Tiranë, në degën e kimisë dhe në vitin 1964 doli oficer, me gradën N/toger. Në vitin 1972-1973 ka përfunduar kursin një vjeçare të specializimit pranë Akademisë së Shtabit të Përgjithshëm në Tiranë. Ndërkohe, në vitin 1981 përfundon kursin pasuniversitar për kimi në Tirane. Më vonë, pa shkëputje nga puna ka përfunduar studimet e larta në degën

Histori-Gjeografi në Shkodër.

Në Forcat e Armatosura ka kryer detyra të ndryshme në armen e kimisë, nga komandant i kompanisë se kimisë në Brigadën e Këmbësorisë në Kukës dhe në Vau-dejës dhe në vitin 1983 është emëruar në detyrën e komandantit të batalionit të Mbrojtjes Civile, në qytetin e Shkodrës. Detyra e fundit ishte një detyrë mjaft e rëndësishme jo vetëm për një dukagjinasi, por për cilindo ushtarak karriere.

Në muajin shtator të vitit 1992, në kuadrin e reformave në ushtri, pas fillimit të proceseve demokratike, del në lirim me gradën N/Kolonel. Për devotshmëri dhe rezultate në pune është dekoruar tre here nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Mhilli, pas daljes në lirim, ushtarak në rezerve, tregoi më së miri virtytet e tij atdhetare e punëtor i palodhur. Pas vitit 1992, i është përkushtuar studimeve historike e atdhetare të krahinës së Pultit. Në vitin 1993, me nismën e tij, u krijua Shoqata Patriotike-Kulturorë "Spani" dhe me këtë rast është zgjedhur kryetar i saj. Mhill Pali me vizion të qarte, megjithëse në një moshë, që mund ti japi përsëri

shoqërisë, kërkon të riorganizojë Shoqatën Kulturorë "SPANI", me gjak të ri, që ajo të jetojë dhe të jetë e gjallë, të jetë aktive në raport me kohën, në shërbim të shoqërisë

Ka botuar librin "Përballja e Madhe e Planit", kushtuar Luftës e Qëndresës kundër forcave ushtarake malazeze, në muajin korrik të vitit 1915. Ai është marre edhe me publicistike. Me emrin e tij ka shumë artikuj në gazetatat e kohës. Kryesisht ka botuar artikuj në gazeta të ndryshëm, në veçanti në gazetën "Shqipëria Etnike" dhe "Dukagjini". Ai ka qenë pjesëmarrës në shumë seminare, që ka organizuar Universiteti i Gracit të Austrisë, Universiteti "Luigj Gurakuqi" në Shkodër dhe Muzeu Historik i Shkodrës, në të cilat ka qenë aktiv me ligjëratat e tij historike, atdhetare, kulturore e zakonore për Dukagjinin e në veçanti për Pultit, të cilat janë botuar nga institucionet përkatëse. Gjithashtu, ai ka marre pjese në seminare e simpoziume të ndryshme, që ka organizuar Shoqata Atdhetare "Dukagjini" në nivel lokal dhe kombëtar. Mhilli ka gati për botim dy libra me temë "Tranzicioni në udhë kryq" dhe "Dukagjini i sotëm në Pultin e vjetër".

Nënkolonel Mhill Palit në pension, për të mirën e bashkësisë dukagjinase dhe të asaj shkodrane, me gjithë zemër i urojmë jete dhe shëndet, prodhimtari studimore sa më të frytshme.

Ndue STRAGU

Trevesa Dardane në Tropojë

Me zhvillimin e pikës turistike në Valbone, Tropoja duket sikur vitet e fundit ka rritur interesin e vizitoreve, megjithëse këta janë aty kalimthi duke l harxhuar paratë e tyre në komplekset e ngritura në mes të majave të larta të Alpeve. Edhe pse historikisht kjo bashki ka nxjerre ish kryeministrin Sali Berisha, serish mbetet një nga qytetet me të varfra të Shqipërisë, e kjo kuptohet që në vështirimin e pare që i hedh qytetit. “Figura e Berishës, ende gëzon atë dashuri të pa plotësuar në këtë qytet, thuajse të izoluar prej Shqipërisë. Tropoja legjendare, në këtë 800-vjetor të të qenit arbër, vazhdon të mbetet e izoluar mes alpeve shqiptare dhe të duhet të kalosh dy dogana për të shkuar në zemër të saj. Por “Treves Dardane”, e ka shndërruar atë në një kryeqytet të hapësirës shqipfolëse, ku për 3 net me radhe skena do te shpaloste kulturën, folklorin dhe këngën Arbënore

Bajram Curri, është qendra e bashkise se Tropojës, pozicionuar në veri të Shqipërisë. Qyteti rrethohet nga disa fshatra te njësisë administrative Margegaj. Ndërsa si fqinje Bajram Curri në veri kufizohet me Margegaj, në verilindje me Tropojë, në jug Llugaj dhe Bujan. Qyteti Bajram Currit ka një sipërfaqe prej 165 ha, në të cilën jetojnë 8500 banorë

Mes traditave te krijuara ne bashkine e Tropojes, Treves Dardane është veprimtaria me e rëndësishme qe organizohet

një stadium të hapur, kurse nata e trete u mbajt në sallën e sporteve të lojërave me dore, në një ambient të mbyllur, për shkak të reshjeve të shiut, që zgjaten gjithë ditën. Por koha nuk e zbehu aspak entuziazmin e festimit që vjen nga skena ku për formojnë grupe të tera artistesh të ardhura nga trojet shqiptare.

Trevesa Dardane u risoll për të 14 vit me radhe nga Unioni Artistik i Kombit Shqiptar me president Azgan Haklaj, l cili vazhdon denjësisht të promovojë vlerat e kulturës dhe traditës shqiptare.

Numri i ansambleve ka qene 40, që sollën më të mirën e traditave nga trojet shqipfolëse. Programi i pasur, pothuajse gjate gjithë kohës ruajti dinamikën e ritmit të këngëve dhe valleve

Në ambientet e pallatit të sportit kane nderuar me pjesëmarrjen e tyre mjaft personalitete, deputet të forcave të ndryshme politike, kryetarë të komunave nga Kosova, si ai i komunës Kline, Sokol Bashota, por dhe biznesmen te ardhur enkas për këtë veprimtari nga USA, siç ishte atdhetari z. Ndue Ftoni, e të tjerë.

Publiku, që ka tejmbushur sallën duket entuziast në këtë nate finale, ku dhe pritet të shpallen fituesit. Mes interpretimeve të shumta, pjese e programit janë dhe artiste të ardhur nga Tirana, e njeri prej tyre është dhe Gjergj Leka.

Jo vetëm këto 20 vitet e fundit, por gjithmonë Tropoja ka ruajtur marrëdhënie shume të afërta me shqiptaret e

son me tepër kryetari i komunës Kline, dhe ish komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të Klinës, Sokol Bashota.

Bashota shtoi, se Tropoja, para se ta shtronte Trevesen Dardane, para 17 viteve ka shtruar trevesen me buke për kosovaret e përndjekur nga Miloshevi. Ai gjen rastin t’i uroje suksese organizatoreve dhe gjithë artisteve në këtë festival.

Notat e folklorit shpesh gërshetohen me notat e këngëve qytetare. Vjen në finalen e mrekullueshme të Treveses Dardane këngëtarja e madhe Raimonda Bushi, me këngën: “Kënga zemrën e rinon”, muzika nga Anton Bushi dhe teksti është shkruar nga poeti talentuar shkodran, Ramazan Çeka.

Duhet theksuar fakti, se këngëtarët e ardhur nga diaspora, duke u nxitur nga këngët e krijuara enkas për festivalin, nuk i thane jo ftesës për të kënduar në Trevesen Dardane. E njëra prej tyre ishte edhe Silvana Margjeka, e cila edhe pse nene me foshnje të vogël, erdhi nga Zvicra e këndoi mjaft bukur këngën e krijuar enkas për festivalin “Trevesa Dardane”, serish kjo një tekst l shkruar nga Ramazan Çeka, muzika Kole Susaj, orkestrimi nga Edmond Zhulali

Pjese e konkurrit prej 40 ansamblesh ishte edhe ai l Rapshe, të ardhur nga shqiptaret, që jetojnë në Mal të Zi e që kryesoheshin nga këngëtarja e

tropojanet. Valltare të shkathet me dinamike e ritëm rrëmbenin duartrokitjet e publikut.

Janë moshat e reja ato që kane përbërë ansamblet, çka dëshmon edhe se tradita po përcillet më së miri nga brezi në brez

Në një moment të veçante, organizatorët kishin ideuar edhe shpërndarjen e disa tituj mirënjohjeje për të gjithë ato personalitete që kane kontribuar jo vetëm për festivalin Trevesa Dardane, por edhe për ruajtjen e traditave dhe vlerave të kulturës shqiptare. E mes tyre, Unioni Artistik i Kombit Shqiptar i dha një titull mirënjohje, si misionar i shqiptarizmit z. Ndue Ftoni, biznesmenit në Miçigan të SHBA, me motivacion: “Për kontributin e tij të shquar në mbështetje të vlerave artistike të kombit shqiptar, në SHBA dhe pasqyrimin e këtyre vlerave në TV e komunitetit shqiptar në Miçigan”.

Nder të tjera z. Ftoni u tha tropojaneve, ... duke shprehur mirënjohjen për vlerësimin që lu bë, mbështes dhe do të rinjtë që vijnë këtu në festival dhe ruajnë traditat e vendit, ku kane lindur e ame rritur. Përpjekjet për të kërkuar një jete më të mire në SHBA e shtynë atë të emigronte para 19 viteve, por ai vend i largët nuk duhet pare si parajse. Gjithmonë mendja e zemra e tij mbeti nga Shqipëria, e me këtë fryme dashurie për atdheun duhen edukuar edhe të rinjtë. Ai u beri thirrje çdo biznesmeni, që zhvillon veprimtarinë e tij jashtë trojeve shqiptare, t’i ktheje sytë nga Shqipëria, e të ndikoje në zhvillimin e saj.

Si çdo festival tjetër, edhe Trevesa Dardane nxjerr fituesit e saj. Juria e profesionisteve nuk e ka pasur të lehte që mes 40 ansambleve të beje shpërndarjen e çmimeve kryesore të festivalit

- Çmimi pare l festivalit u fitua nga ansambli “Emin Duraku” nga Shkupi i Maqedonisë. Me çmim të dytë u nderua ansambli “Pjetër Bogdani” Has, Shqipëri
- Me çmimin e tretë grupi i Librazhdit
- Çmimi l publikut grupi «Rrafsha» l Malit të Zi
- Çmimi «Fatime Sokoli», Marije Lajçaj nga Tuzi
- Çmimi «Panajot Kanaçi», Skënder Haklaj
- Çmimi «Nënë Tereza», Kadri Morina dhe Shkëlzen Luka

Artistet e rije e përcollën me mjaft entuziazëm marrjen e çmimeve të para që lakmohen nga gjithë konkurrentet. Por pavarësisht kësaj, të gjitha ansamblet këtu i dhëne koloritin e bukur Treveses Dardane, duke ia rritur edhe më shume autoritetin kësaj veprimtarie, të vlerësuar si nder më të rëndësishmit që organizohen në kuadër të promovimit të vlerave dhe traditave të folklorit shqiptar.

Kozeta BRUÇI



këtu qe prej 14 vitesh. Edhe këtë vit për 3 net me radhe, qyteti verior u shndërrua në kryeqytet të kulturës kombëtare. Dy netët e para të festivalit, në datën 10 dhe 11, u zhvilluan në qendër të qytetit, në

Kosovës. Banoret e dy pjesëve shqiptare shkëmbejnë marrëdhënie ekonomike e kulturore me njeri tjetrin, e këto marrëdhënie u forcuan me tepër në ditët e vështira të luftës në Kosove. Këtë e thek-

mirënjohur, Marie Lajçaj.

Ne festivalin Trevesa Dardane, më shume kane dominua vallet, ç’ka linte përshtypjen se ashtu siç është humori për shkodranet janë edhe vallet për

Sekretet e jetës së njeriut

PERIPECINAT (GËZIMET DHE HIDHËRIMET E SAJ)



Jeta është ëndërr, meshumë parashikime, me krijimtari, fantazi por edhe me shumë komplikacione. Ka sekretet e veta.

Njeriu që në moshën adoleshente, sidomos kur mbaron shkollën e mesme, merr

njuhuritë e para për jetën. Në këtë fazë fillon pjekuria për të parashikuar, për të gjykuar e për të marre vendime për të ardhmen.

Ne kete fazë çdo i ri ose e re ëndërron e mendon në të cilin universitet me studju, në çfarë dege me u profilizu ose çfarë profesioni me marrë. Ku me punu, me ke me bashkepunu, me ke me u shoqëru, ku me banu, kur me u feju e ke, me ke me u feju, kur me u martu, etj.

Prandaj të gjitha këto vendime e të tjera, më parë duhet me i studju, analizu, pastaj me marrë vendimin, sepse kanë të bëjnë me fatet e jetës për çdo njeri sidomos të rinjtë e të rejtat.

Çdo vendim ka komplikacionet e veta, (peripecinat) anë të pozitive e negative në çdo kohë. Nisur nga këto e të tjera kërkohet një analizë e plotë me pjekuri, me logjikë e largpamë.

Këto vendime kërkojnë intuit, vullnet, guxim, vendosmëri për të arritur sukseset e parashikuara në jetën personale dhe familjare. Këto vendime i marrin të rinjtë e të rejtat që janë me vizion e largpamësi.

Jeta ka baticat dhe zbaticat (dallgët) e veta, duhet guxim e vendosmëri me i përballu.

Jeta është film:” Kur filmi është i realizuar mirë, të tërheq, ke qejf, ke dëshirë me e pa”

Në të kundërt të duket kohë e humbur. Prandaj, jetën po e kalove keq, s’ke qejf me e kujtu.

Jeta nuk shkon si në vaj, ka oshilacionet e veta, por një fillim i mbarë të jep shpresë, besim dhe energji të reja për të punuar, për të avancuar përpara në vendimet që ke marrë.

Jeta është nocion filozofik: “është shkollë e madhe për çdo njeri, sepse pregatitet në praktikë e në teori” Këtu kalitet, formohet, edukohet për t’i shërbyer vehtes, familjes e shoqërisë.

Jeta është e mbushur plot me ngjarje: Gëzime, dëshitime, hidhërime, por, s’ke pse e paragjykon.

Jeta fillon:

Kur njeriu është në gjendje me kuptu se ç’është jeta.

Kur njeriu ka arritur pjekurinë.

Kur njeriu din me vlerësu.

Kur njeriu din me gjyku.

Kur njeriu din me dashuru.

Kur njeriu din me shiju.

Kur njeriu din me organizu.

Kur njeriu din me drejtu.

Kur njeriu ka arritë përvojën.

Kur njeriu ka arritë eksperiencën teorike e praktike.

D m th, jeta fillon:

1. Kur nxënësi merr maturën në gjimnaz ose shkolla të tjera të mesme
 2. Kur vazhdon universitetin.
 3. Kur fillon punën.
 4. Kur krijon familjen (martohesh)
 5. Kur vazhdon rritjen e fëmijëve.
 6. Kur vazhdon të martojë fëmijët.
- Jeta fillon:**
Në moshën 20 vjeç (kur mbaron mbaron shkollën e mesme).

Deri në moshën 40 –vjeç vazhdon moshë e parë.
40-60 vjeç vazhdon moshë e dytë.
60-80-100 vjeç është moshë e tretë.
Jo të gjithë njerëzit i kanë këto kritere:
Disa s’kanë aftësi mendore
Disa s’kanë aftësi fizike.
Disa të tjerë s’kanë kushtet material e financiare
Disa të tjerë s’kanë ambientin
Disa të tjerë s’kanë gjendjen shëndetësore.

Jeta e njeriut është e mbushur plot me sakrificë. Njeriu gjatë jetës duhet të jetë guximtar por edhe frikacak në raste të veçanta.

Njeriu në shumë raste pëndohet për fjalët që flet ose veprimet që kryen në praktikë. Por ka raste që pëndohet për fjalët që nuk i flet ose për veprimet që nuk i kryen në kohën e duhur

Një fjalë e urtë popullore thotë:
“Mos pre ose fol pa u matë, se o të del shkurt ose të del gjatë”

Komunikimi me edukatë, në mënyrë njerëzore ka shumë rëndësi.

Në qoftë burrë, në qoftë gru kur flet avash e ëmbël, e mbyllë pleqninë, ndalon pushkën, ndalon adhtinë, ndalon vrasjen ose shpëton shpinë pa u djegë nga gjakësi e të tjera.

Kur s’dinë me folë, s’dinë me gjyku, nxehen gjakrat, fillon sherri, fillojnë mos-marrëveshjet, konfliktet, në shumë raste kanë shkuar në rrahje ose në vrasje. Një fjalë e urtë e popullit thotë: **“fjalë nga njëfjalë nxehet belaja”**

Prandaj, duhet me kenë i matur, me folë avash, ëmbël e mos me acarë gjendjen, po deshte me gëzue jetën: **jeta është shumë e shtrenjtë.**

Jeta është si një mozaik lulesh, ka shumë faktore të cilët duhet të studiohen me hollësi pastaj të përcaktohen rrugët, format e metodat e punës për të arritur sukseset në realizimin e vendimeve në jetën e përditshme.

Jeta ka shanset e veta, duhet me i shfrytëzu. Jo të gjithëve u vjen shansi. Ka shumë raste që janë më të ditur ata që nuk iu jepet rasti, jepet shansi me u provu në jetë, sesa ata që lu punon fati, fillojnë punën ose detyrën. Zogu njëherë të vjen në dorë. Një këngë qytetare shkodrane thotë: **“Zogun në dorë unë kur e pata, kimetin nuk ja dita, iku fluturoj si flutur dhe s’mujta me i marrë erë”**

Kurse vëllezërit lleshi me këngën e tyre thonë **“Kur u ndamë, kto na ranë, dikush në këmbë, dikush në avion, dikush fatn për ministër, dikush kalin për kapiçë”**

Jeta ka të papriturat e veta: “Shërbim e fat shkojnë krahas. Në i bash shërbimin punës së mirë e mira do të vij. Në të kun-

dert do të kesh pasoja negative. Po ndodhi gjë e keqe njerëzit thonë: ish fatt, ish risk, ish e shkruar, ky është fati i tij “

Jeta është legjendë. Në moshën 70-80 vjeçare të duket e pabesueshme nga ke kaluar, si e ke kaluar, kë ke njohur, e sot nuk jetojmë më ose gëzimet ose hidhërimet që ke kaluar në jetë.

Disa nga faktorët kryesorë të jetës po i shpjegojmë më poshtë:

Jeta është mundsi, duhet ta pranosh, Jeta është bukuri, duhet t’i kënaqesh, Jeta është lumturi, duhet ta shijoshë, Jeta është thirrje, duhet t’i dalësh përballë, Jeta është detyrë, duhet ta kryesh, Jeta është lojë, duhet ta luash, Jeta është pasuri, duhet ta ruash, Jeta është dashuri, duhet ta perjetosh, Jeta është xheloz, duhet ta sfidosh, Jeta është miqësi, duhet të bashkëpunoshë,

Jeta është fshehtësi, duhet ta zbulosh, Jeta është tradhëti, duhet ti ruhesh, Jeta është premtim, duhet ta plotësosh, Jeta është pikëllim, duhet ta kapërcesh, Jeta është këngë, duhet ta këndoshë, Jeta është tragjedi, duhet ta kuptosh, Jeta është enigmë, duhet ta zbërthesh, Jeta është kënaqësi, duhet ta meritosh, Jeta është shkollë, duhet ta përvetësosh (mësosh),

Jeta është e çmueshme, duhet ta nderosh,

Jeta është shprehëse, duhet të shprehësh,

Jeta është kulturë, edukatë, duhet ta demostrosh,

Jeta është liri, demokraci duhet ta vlerësosh

Jeta është shumë e gjatë, kur s’dinë ta jetosh,

Jeta është shumë e shkurtër, kur ti din ta jetosh,

Kur ti je i lumtur të zgjatet jeta,

Jeta të zhgënjën, duhet të gjesësh energji të reja për ta kapërcyer.

Jeta është “luftë”, duhet të “luftosh”.

Jeta është fantazi, duhet të krijosh.

Jeta është sakrificë, duhet të sakrifikosh.

Jeta është forcë, duhet një vendosmëri,

Jeta është guxim, duhet mençuri, vullnet, këmbëngulje e largpamësi.

Jeta është respekt duhet ta respektosh,

Jeta është dritë, duhet të mësosh që të bëhesh njeri, me personalitet, karakter e dinjitet.

Jeta është sfidë, duhet ta sfidosh, në rrugë e forma të ndryshme.

Jeta është vështirësi, duhet sakrificë, mençuri.

Jeta është flori, duhet mos me e nxi me punë të këqija,

Jeta është moral, duhet edukim pozitiv që në fëmijëri.

Jeta ka kodet e veta morale, duhet t’i zbatojmë në praktikë e në teori.

Jeta prodhon konflikte, duhet t’i zgjidhim në mënyrë paqësore

Jeta lind urrejtje e mosmarrëveshje të ndryshme, ideologjike, politike, fetare, racore, krahinore, gjinore dhe profesionale, në drejtësi e të tjera, duhet të gjejmë

mekanizmin e driturisë, dashurisë e të zemërgjërësisë për mirëkuptim tolerancë e bashkëjetesë

Jeta është shumë e shkurtër kur ti e kalon mirë me familje, me shoqëri, me miqësi e të tjera.

Jeta ka sekretet e veta, duhet ti zbulosh, që ta përballosh.

Jeta është histori, duhet ta shkruash, ta trashëgosh, që të jetosh.

1. Dasma është simbol i jetës së njeriut,
2. Trashëgimia është lumturi e jetës së njeriut,
3. Jeta fillon me vaj që kur lind njeriu,
4. Jeta vazhdon me gëzime, hidhërime, mundime e vajë nga njeriu,
5. Jeta përfundon me vdekje, e me vajë për çdo njeri,
6. Jeta vdes, por vdekja nuk harron.

Jeta vazhdon edhe kur ndodhin tragjedi, por duhet durim, forcë, guxim dhe shpresë me i përballu.

Jeta vazhdon çfarëdo që të ndodhi: “I vdekuri me të vdekur, i gjalli me të gjalle”. I gjalli duhet të jetojë me shpresë dhe optimizëm për të kapërcyer çdo vështirësi ose fatkeqësi. Njeriu vdes, por ai që bën punë të dobishme për shoqërinë, e lë një emër të mirë, kujtohet në shekuj, ai nuk vdes kurrë.

Një mbret po kalonte në një krahinë, i ra rruga me kalë nëpërmes një varreze. Pyeti shoqëruesin, i cili ishte nga ky vend: **A është kush i gjallë në këto varreza?**

Ai u përgjigj: **Po, të gjithë heronjtë dhe dëshmorët që kanë emrat në këtë lapidar. Këta kanë dhënë jetën për atdhe, për liri e për demokraci. Këto janë gjallë e nuk vdesin kurrë!**

Njeriu duhet të punojë me ndërgjegje, të jetë i kompletuar me të gjitha, tiparet, virtutet, vetitë e cilësitë e mira njerëzore. Të jetë i thjeshtë, të komunikojë me të gjitha kategoritë, me të gjitha shtresat.

Njeriu në rrallë të parë duhet të jetë njeri i thjeshtë, sepse edhe po **që profesor, doktor, shkencëtar, artist, ministër, kryeministër ose president,** s’është asgjë po nuk i pat cilësitë e lartpërmendura.

Njeriu duhet të manifestojë në personalitetin, karakterin e dinjitetin e tij, **ndershmërinë, zemërgjërësinë, bamirësinë, filozofinë, filantropinë, bashkëpunimin, mirëkëputimin, tolerancën, virtutet, vetitë e cilësitë e qytetërit bashkekohor.**

Këto kritere e bëjnë njeriun të pavdekshëm, kur i zbaton në praktikë e p.sh. bën shpikje racionalizime, bamirësi në doli të shoqërisë, shkruan vepra, vepra politike, ushtarake, historike, filozofike, shkencore ose artistike, kulturore e të tjera.

Populli thotë **“Gjithmone nalt u ngjithsh, po kurrë në majë mos hypsh”,** sepse po hype në maje do të rrëzohesh. Kjo do të thotë se i ëshë rrit mendja, ke harru nga ke ardhë e kush ke qenë.

Përfundimi, jeta është: “Si një person, që është i ftuar në dasëm, sa është në gjendje ky me e kalu me lezet, me alegri. me atë familje dhe me atë shoqëri!”

Si na shfaqen *Vegimet e fundit*

Problemi i artistit dhe raporti me produktionin e tij, janë thelbi i tematikës së veprës *Vegimet e fundit* të autorit Meritan Spahija. Vepra është e konceptuar nga ana formale si një trilogji në prozë, në të cilën vegimet e shkrimtarit, në perceptimin e realitetit të brendshëm dhe të jashtëm, janë të pjesëzuar, siç duket, sipas një rendi kronologjik të përjetimit të tyre: *Vegimet e para*, *Përmes vegimeve* dhe *Vegimet e fundit*. Uniteti formal i tyre nuk mbështetet vetëm nga këndvështrimi kronologjik, por mbi të gjitha në evoluimin letrar dhe konceptues të vetë autorit.

Nëse te pjesa e parë kemi në përgjithësi ndonjë luhatje për njohjen e vetes së tij si artist i letrave, te e dyta vetëdija për një gjë të tillë është më e plotë, ndërsa tek e treta pjekuria është më e madhe dhe ndihet thellësisht i shenjtëruar si i tillë. Madje te tregimet e pjesës tretë kemi trilogjinë me tregime *Lulet e kumbullës*, përbërë nga tregimet: *Lulet e kumbullës*, *Shkarpat* dhe *Odat*, që në unitetin e tyre formal qëndrojnë si një e tërë, sepse trajtojnë një subjekt të vetëm.

Te pjesa e dytë *Përmes vegimeve* janë vendosur copëza nga prozat tashmë të botuara në veprat e mëparshme, që megjithatë rrinë mirë në tërësinë e veprës, pa cënuar aspak harmoninë e saj. Digresionet e mundshme janë të gjitha funksionale në shtjellimin e temës së përgjithshme dhe të qëndrimit të vetë autorit për botën, e cila kapet pikërisht në pikat më të rëndësishme për njeriun-artist, së pari në identifikimin e dhuntisë, së dyti në trajtimin e temave universale, si dashuria, jeta dhe vdekja. Si rrjedhim, duket e drejtë të themi se uniteti i veprës është siguruar më shumë sesa nga një ndarje e qëllimshme, nga fryma artistike dhe pëmbajtësore e librit.

Realizimi artistik i kësaj vepre është arritur përmes një debati të përhershëm të autorit me shqetësimet e natyrës së tij prej artisti. Në asnjë vend të librit nuk shohim ndonjë kujdesje të tepruar për kuptimshmërinë e produktit të tij nga publiku. Përkundrazi ai, i zënë rob nga frymëzimi mbytës, është kujdesur të hedhë në letër ngacmimin e gjetjes, që në shumë raste janë përjetime, që e bëjnë atë të ndryshëm, të huaj, dhe mosreagues ndaj mjedisit, në të cilin ai jeton.

Këto tregime janë në përgjithësi fryt i përjetimeve rreth një dekade e gjysmë të kohëve të fundit, pra janë mjaft të freskëta. Individit i gjendur i paralizuar në rrjetën e institucioneve të shprishura dhe në një kaos vlerash, ndihet i paafetë të reagojë ndaj tyre. Çon një jetë pasive. Është i paorientuar në rendin e ri shoqëror, i cili në rrugën e tij kalimtare e vendos individin në një situatë absurde dhe të pakuptimtë.

Një gjë e tillë trajtohet përmes tregimit të shkëlqyeshëm *Fletët e një ditarit të humbur*, që është vendosur në fillim të librit. Tregimi fillon me përgatitjen e lexuesit për ditarin e pritshëm, i cili gjehet rastsisht në një rrugë të qytetit dhe zgjon kureshtjen e mprehtë të personazhit-artistit, i cili me padurim pret kthimin në shtëpi për ta lexuar dhe për ta shfrytëzuar si lëndë për artin e tij. Pasi e lexon, sheh të udhës të mos ndërhyjë në të, por të na e paraqet ashtu siç është në ato fletë të humbura. Në ditar autori flet në vetë të parë ashtu si në shumë tregime të tjera. Në këtë tregim rrëfëhet duke u nisur nga ai që shkruan (*autori i tregimit*), pastaj kalohet (*përsëri në vetë të parë*) tek ai që shkruan ditarin dhe, së fundi, objekti i shkrimit të ditarit, personazhi i çuditshëm që shkon e blen një varr. Drama e identitetit të humbur, preket dhimbshëm, duke filluar nga personazhi i çuditshëm e që përshkon edhe të tjerët (shkruasin e ditarit

dhe shkruasin e tregimit), duke na lënë në mëdyshe edhe të vetë tregimtarit:

“Kush asht ky e ç'ka bahet? Çka janë këto fletë? A asht me të vërtetë një ditar? Apo një sajim i rastsishëm. Fort dyshojmë. Kush t'i ketë shkruar këto rreshta? Pse ai i marri që takova, shkonte tue kërkue rrugës? Në atë që, unë, sapo “diçka” gjeta. A thue një i marrë shkruen për një të marrë tjetër? Apo për vet-veten? Nuk e di.”

Në këtë tregim, loja mes jetës dhe vdekjes, normales dhe anormales (të cilat këmbëjnë rolet në varësi të këndvështrimit, duke lënë të lirë lexuesin, jo vetëm për një qëndrim subjektiv, por edhe për shkak të kësaj, edhe



meditativ), apo njeriut dhe *“humbjes së identitetit”*, na shfaqet tragjikisht me këtë *“personazh”* të trazuar e që fare mirë mund të jetë secili prej nesh i përfshirë, qoftë edhe pjesërisht, sepse të gjithë vuajmë nga humbja e aftësisë së matjes së vlerave, meqë *“vlerë”*, për shkak të mungesës së *“modelit”*, shpesh quhet antivlera dhe mediokriteti, saqë njeriu (i çuditshmi, që në kushte të tjera mund të ishte një njeri krejt tjetër, në pozicionin e tij meritues), vendos të vërë një kapak vlerave të veta të pavlerësuar (*për shkak të mungesës së etalonit*), mbi të cilin shkruan edhe një epitaf...

“Këtu prehet një llambë e vogël që desht me ndriçue në këtë botë, e cila, e mulueme terrinash, e shuejti atë.”

Beteja e lashtë me të cilën është përballuar njeriu: vlera dhe antivlera, normalja dhe anormalja, jeta dhe vdekja të përziera. Nuk dihet filli i njëres dhe fundi i tjetres; nuk dihet ku mbaron jeta dhe ku fillon vdekja. Lojë e lashtë tragjikomike dhe gjithashtu edhe e njeriut modern, pa një pikë reference, pa

një bosht etik të qëndrueshëm. Individit që ka humbur arsyen e të jetuarit e ndihet i vdekur, sepse atij i është shuar shpresa, i janë shuar motivet, vlerat që mbajnë në jetë ekzistencën e tij. Tronditës është fati i qytetarit që duhet t'i përshtatet këtij realiteti me vlera diametralisht të kundërta. Ai sheh diferencat, por nuk mund ta bëjë përmbysjen që në origjinë e tyre, sepse ajo që për të është një etikë universale e vetërealizimit të tij, tashmë është kthyer në antivlerë, si rrjedhim i gjendjes kaotike, në të cilën i duhet të jetojë.

Tregimet me temë dashurinë japin ndijimin e artistit/letrar në lidhje me personin që ai dashuron. Bëhet një hetim i hollësishëm i ndjenjës së natyrshme për femrën. Ajo, fem-

“Ajo çka rreth meje ekzistonte, ngjante me një masë të qullët dhe të rrjedhshme. Unë, në mesin e saj. Pa rrjedhë. Po, veç, sa fillue. Nuk isha i sigurtë se, kur, atë grue, e kisha takue: në të shkuemen, apo në të ardhmen time.”

Përgjithësisht, tek të gjithë tregimet, fjala është vendosur mirë në rrjedhën e ligjërimit të brendshëm, pa krijuar kërcitje formale, emocionale dhe ideore. Ndjenja dhe mendimi, posaçërisht te tregimet me temë dashurinë, ruajnë një harmoni të natyrshme pa pasur dominimin e njëres mbi tjetrin apo anasjelltas.

Trilogjia te tregimeve *Lulet e kumbullës*, *Shkarpat* dhe *Odat* trajton jetën e artistit në mjedisin familjar, i cili si i dënuar i përjetshëm për të vëzhguar çdo gjë që ndodh rreth tij, s'është në medituari për gjithçka. Në një moshë rinie të pacaktuar i ndodh të takohet me humbjen e njeriut të afërt. Elementi tragjik, që e shoqëron këtë ngjarje është përshkruar si një efekt i ngjarjes tek artisti, i cili ndihet më tepër sesa pjesëmarrja aktive në ngjarje, një perceptues i padukshëm i saj. Edhe këtu si në shumë tregime të tjera, ndodhia jepet si përjetim i artistit dhe jo si një përshkrim i ndodhisë. Institucionet që në përgjithësi janë rregulluese të mbarëvajtjes së jetës së zakonshme, këtu paraqiten si kufizime paralitike të individit të zënë ngushtë nga disa rregulla, të cilat, në vend që të kryejnë rolin e tyre brenda familjes, bëhen pengesë për të. Tek *Odat*, rriti i pritjes së vizitave, si një detyrim i qytetarit ndaj qytetarit, por që në zbrazëtinë e tij ka humbur funksionin e vet, gjë që e kthen atë në një zakon fosil, ngarkuar me efekte zakonore të pakuptimshme, shihet nga personazhi/artist si një heqje lirie dhe si pengesë. Njeriu artist dallon nga ai i zakonshmi edhe brenda familjes, sepse ai nuk është i zakonshëm për të zakonshmen. Edhe pse dhimbja është e fortë edhe për të, triumfi i dashurisë për jetën dhe të jetuarit intensiv të saj janë më të forta tek artisti, i cili nuk don t'i mungojë dëshmimit për të cilin është i thirrur.

“Dora që vazhdonte me mbërthye krahun tim më tregonte se duhej të tregoja ma shumë durim e të përballoja vuetjen, ashtu siç ma kërkonte detyra. Qysh i vogël i isha bindë pa diskutim, sikur të mos ishte vëllai im i madh, por shumë ma tepër. Më erdhi ta përqafoja e që shfreja me lot në supin e tij, ashtu siç bapja dikur. U mbështeta në shpinoren e poltronit tim dhe përfundimisht u dorëzoza.”

Dhimbjen nuk e sheh si fillimi i një dhimbjeje, por si fillimi i një rifillimi a shprese, e cila do të shkaktojë dëshirën për vazhdimin e rrjedhës së saj duke përjetuar tashmë çastet e tjera të jetës që duhet të gëzohen prej tij.

Siç është shprehur më sipër, mund të themi se tregimet e veprës *Vegimet e fundit* kanë në qendër të tyre tematikën e njeriut/artistit në një botë kaotike dhe paralizuese, e cila e ka kthyer artistin anonim ose i ka dhënë atij tashmë një rol dytësor a diçka më pak. Artisti, i ndier si i marrë peng nga institucionet e botës moderne, kërkon të fitojë lirinë përmes hapësirave të tyre. Tani, ai nuk synon të bëjë zëdhënës në të tjerëve por vetëm zëdhënës në vetvetes, duke u marrë me një hetim të thellë të botës së tij dhe duke kërkuar shkaqet e shqetësimeve. Temat e mëdha universale të shpeshrrahura nga artistët shfaqen këtu si një pasojë e ndodhisë sesa si ndodhi në vetvete.

Prof.as.dr. Vinçens MARKU

Droga, varësia dhe si ta shmangim atë

Lufta kundër gjithë llojeve të drogave është një problem madhor kudo në bote, madje vitet e fundit dhe në vendin tone, jo vetëm persë i takon kultivimit të mariunes, kanabis, alkool, duhan e të tjera, por ka filluar dhe të konsumohen në forma të ndryshme, droge me kombinim!

Varësia nga kokaina ose nga lende të tjera të ngjashme psikotrope (psikostimulose) (toxicomania). Tozicomania vjen nga fjala greke = toxikon = helm dhe mania = marrzi, që nënkupton një varësi fizike dhe / ose psikologjike nga një ose shumë lende kimike të jashtme: toksike, analgjezike, stimulose ose psikotrope pa justifikim mjekës, që përben sot një problem madhor botëror qoftë për shëndetin publik, qoftë për gjithë shoqërinë në përgjithësi! Pra, është problem social me pasoja për individin, qoftë për gjithë shoqërinë në përgjithësi kjo dominon në zonat urbane dhe kolegjet dhe shkollat e larta midis adoleshenteve dhe të rriturve 18 – 40 vjeç sidomos meshkuj, por pa përjashtuar as femrat! Është një fakt që ndërhyr në disa aksidente të rrugës ose të punës me pasoja të renda.

Si do që në shumë vende të botes kemi cilësim si droga të ligjshme (kafe, duhan, alkool e të tjera) dhe jo legale (të ndaluara) sipas vendeve (kokaina, heroina, amfetaminat e të tjera! Kështu në Francë ndalohej alkooli dhe stuperfiantet (morfina), në Holandë dhe Jamajka lejohet dhe kanabis! Filimisht dhe në përvijim abuzimi me droge kushtëzohet nga ndërveprimi kompleks dhe i ndërlikuar ndërmjet vetive kimiko – farmakologjike dhe disponimit të drogës, personalitetit të personit dëshirës së personit konsumator dhe kontekstit mbjentat me të cilin konsumohet droga: Konsumi i shume drogave së bashku, me efekt farmakologjik të ndryshme po rritet dita ditës kudo në bote.

Po ashtu dhe forma të bashkimit të drogave të ligjshme me ato të ndaluara (heroin, koka, e të tjera), jo vetëm me thithje ose tymosje, por dhe në përkufizon në vene (shiringa) aq sa po behet problem dhe për urgjencat e spitaleve. Personat e varur nga droga kane tendence të lehtësojnë efektin e një droge duke e shoqëruar me një tjetër si p.sh përdoret alkooli me heroin për të moduluar efektin euforike të kokainës ose për të rritur efektin e një tjetre p.sh : shoqërimi i Benzodiazepines (valium) dhe Methadon ose kokainë dhe heroin tek ato që janë trajtuar në spitale me Methadon. Abuzimi i zgjatur me koka dhe psikostimulus mund të provokojë një numër të madhe efektsh të pa dëshirueshme si problem në mushkëri, problem genital. Turbullimet para – ekzistuese si Hypertensioni (HTA) ose një problem me zemrën të cilët mund të acarohen me përdorimin e këtyre drogave ose nga përdorimi i kombinuar ose mund të rendohen nga rreziku i ndërlikimeve mjekësore.

Abuzimi me droga rrit dhe rrezikun për tu ekspozuar ndaj virusit HIV (SIDA) nga që minohen (ulen) forcat mbrojtëse të organizmit; pra drogat çojnë në imunodepresion sidomos tek personat me HIV (SIDA) sipas të dhënave botërore, SHBA, Itali, Spanjë, Tailande, Kinë e të tjera.

Drogat e pa ligjshme (jo legale) janë.

Kokaina një stimulues dhe një anestetike (mpirës) lokal për operacione të vogla si në sy , goje e të tjera, dhe ka veti vazokonstriktore (ngushton enët e gjakut). Gjethet e

koka (Erythroxilon coca) përmban deri 0.5 -1 % kokainë. Kjo jep efekte fiziologjike dhe problem te sjelljes kur ajo merret nga goja, nga zorra e trashe (rektal) ose me inhalacion – kokaina shton përqendrimin e disa neurotransmetusve si : Dopamin, noradrenalin, serotonin duke u përqendruar në neurone dhe duke bllokuar kapjen e tyre. Në shumë vende të zhvilluara të



botes, por këto vitet e fundit dhe në vendin tone në zonat urbane si Tirana, Durrësi, Vlora, Shkodra e të tjera është rritur jo vetëm kultivimi i drogave, por dhe konsumimi i tyre në forma të ndryshme dhe mjaft persona janë beret e varur (toksikoman), kjo ka ndodhur për faktin e përdorimit të drogave në kombinim siç u përmend dhe nga që disa jashtë vendit ose në qendrën e Detosikimit në Tirane janë trajtuar në Methadon, të cilët arrijnë të tolerojnë një doze deri 5 gr koka në dite.

Por intoksimi me kokaine në mënyrë të menjëhershme ndodh në mënyrë aksidentale në manovrat mpirës në goje, në sy (ku doza vdekje prurë është 1-2 gr, por mund të kemi kolaps kardio – vascular dhe me doza të zakonshme prej 20 mg. Konsumi i zgjatur i koka mund të çojë në delirë, pranoja dhe vegjime (halucinacione nga sytë dhe veshët), një gjendje e ngjashme me të alkoolizuarit, ku nuk ka mendësi të arrihet frenim, por eksitim (agjitin) psiko-motor dhe mbi aktivitetet e simpatikusit deri në një depresion të rende.

Cannabis sattiva: përmban 400 lende aktive në përbërjen e saj. Ajo përdoret me cigare nga gjethe e kanabis ose lulet e mariuanes dhe përmban 0.5 – 1 gr lende aktive. Marrja e zgjatur e mariuanes çon në helmim të zgjatur (kronik) të njëjtë si me koka dhe opiate; ku jep depresion kronik të moderuar deri të rende.

Personat e rinj që tymosin mariuane zhvillojnë me vonese turbullime njohëse dhe neuro – psikologjike, por kjo perdispozon për përdorim të shumëllojshme të drogave dhe marrje alkooli. Nga ana fizike përdorimi i mariuanes dhe kanabis shfaqet me skuqje të syve dhe rrahje të zemrës që janë pasoja të menjëhershme te tymosjes, ka

dhe gjendje ankthi. Mund të ketë kriza te angorit të zemrës si në rastin e marrjes së nikotinës me duhan. Prandaj, këtu duhet të ketë shume kujdes personat me rrethana familjare për sëmundje të zemrës.

Tolerance dhe varësia fizike – ato që marrin rregullisht mariuan zhvillojnë shpejt vartësi, por tolerojnë rrahjet e zemrës dhe afekte të tjera fizike, ndërsa skuqja e syve zhduket më vonë. Në shumë vende përdoret nga goja, me hundë ose me injeksion.

Meth – amfetamina (meth, speed, glacs, ose crystal) që përdoret nga të rinjtë për të siguruar ndjenjën e euforisë (kënaqësisë) në vendet e zhvilluara- si efekte anësore ka dhimbje koke, ose përqendrim (ulje përqendrimi, rënie të oreksit, prerje barku, të vjella ose diarre, turbullime të gjumit deri sjellje agresive, paranoja dhe psikoza.

Po këtu edhe LSD (diethyl-amidi i acidit Liserjic) është një droge shume e forte (potenciale)ku me doza të vogla nga goja 20 mcg (microgram)mund të provojë efekte psikologjike dhe fiziologjike të rëndësishme si: rrahje të shpeshta të zemrës, rritje të tensionit të gjakut, zgjerim të bebes së syrit, dridhje, rritje të temperaturës trupore në minutat e para që përvijojnë përdorimin e tij në doze 0.5- 2 mcg/kg, ka modifikim ekstrem të humorit pas 30 min nga përdorimi.

Për sa i takon shkaqeve që i çojnë individët e ndryshëm meshkuj apo femra drejt përdorimit të drogave të ligjshme (duhan, alkool, e të tjera) ose të aty ilegale (të ndaluara si koka, kanabis ose psikotrop të tjera si amfetamina) mund të themi se janë nga më të ndryshmit, kështu dhe përpjekjet për të larguar këtë varësi është shume e vështire.

Pasojat shëndetësore: veç efekteve të menjëhershme mbi psikikën, kemi varësinë (toksikomane) me efekte fizike, familjarizim, sëmundje oportuniste e të tjera, që mund të çojnë deri në përfundim të keq, letal (vdekje); mbidozim, koma dhe ndërlikime të renda, dhe këtë rrezik e kane 5-10 here më të larte ato me varësi, krahasuar me popullimin ekuivalent ose jo përdorues. Sipas të dhënave, me vdekjeprurësi është:

- Duhan: me 4 milion vdekje botërore, pra 62 vdekje për 100 000 banorë ose 1 vdekje në çdo 8 sekonda (vetëm në Francë ka 60 000 vdekje vjetore)

-Alkooli: provokon të paktën 750 000 vdekje në vit, afro 12 / 100 000 banorë, ku në Francë 45 000 vdekje vjetore.

Në Mbretërinë e Bashkuar (Angli) sipas një studimi 1998 rezulton se 11% e adoleshenteve 16-17 vjeçar janë ndaluar për krim të përdorimit të opium, sipas të dhënave të OMS, 1.5% e 16-20 vjeçarëve kane provuar të përdorin opium.

Konsumi i lendeve psikotrope atakon me shume meshkujt se femrat, përjashtuar duhanin, ku dallimi është fare i vogël; për sa i takon moshës, ajo u takon adoleshenteve dhe të rriturve nga 18-40 vjeç, përjashtuar alkoolin, ku dominon në moshat e mëdha.

Sipas të dhënave franceze të vitit 2010: kishte 8. 8 milion përdorues të rregullt të alkoolit, 13. 4 milion përdorues të përditshëm të duhanit dhe 1. 2 milion përdorues të kanabis, lënda më e përdorur kudo në bote ku lënda aktive e saj është: Tetra – hydro-kanabinoli merret me cigare ose thithet me pipe (cibuk) ose si çaj ose si bis-kota (space-cake)

Trajtimi: Ngaqë shkaqet që i çojnë individët, meshkuj apo femra, të përdorin që nga drogat e lejueshme (alkool, kafe duhan, e të tjera) deri në ato të ndaluara (kanabis, koka, heroin, amfetamina e të tjera) janë nga më të ndryshmet: por kur ato bëhen të varur (toksiman) është shume e vështire për ta hequr ngaqë është dëmtuar shëndeti mendor dhe fizik, prandaj detyra është të merrni vendim pa u bere të varur, ta lini sa me pare dhe për këtë të merrni vendim. Për trajtim duhet të përfshihet e gjithë gama e kurimit psikologjik, si : psikoterapi individuale, familjare e psikologjike. Pra, duhet një trajtim kompleks në bashkëpunim me shume specialist dhe specialitet, e pra është një trajtim multidisiplinar si psikoterapeut, mjek i përgjithshëm, toksikolog, reanimatolog e të tjera. Preparatet kundër toksimanise kane rendësin e vet si antagonist të drogës, por ato jepen në spital reparte të toksikologjie si psh: AKAMPROSTAT ose Buprehorpin si lende me veti psikotrope e afërt me opiate, por në rastet kur kemi rritje te TA (tencionit) përdoret CLONIDIN e cila ka veti hypotenzive (te ul TA) dhe efekt qetësues të afërt me opiate. Ndërsa për duhanin jepet BRUPRPPION dhe VARENICLINA qe kane veprim te ngjashëm me NIKOTINEN dhe ul efektet e mungesës se Nikotinës tek ato që e kane lënë duhanin. Po ashtu dy lende që lehtësojnë varësinë e drogave janë: Loperamidi (ilaç kundër heqjes së barkut) dhe Dextromethofani, ka efekte të vogla euforike, ka veti të uli ndjenjën e mungesës së drogës pas lënies së saj.

Pra, lenia e drogës është një detyrë e vështire, kjo nuk është thjesht një dite pa droge, por do te thotë ndryshim i disa aspekteve te jetës:

Të evitohet stresi, përpigu të besh një jete të qete, mos merr alkool, duhan, qëndroni larg shoqërisë të pijetarëve të alkoolit, të duhanit, kur keni shqetësime drejtojuni qendrave shtetërore ose private të psikologeve. Shmangni qe ne fillim motivet që u çojnë (shpien) në përdorim të drogës si: frike sociale, ankth, ndjenje faji, zhgënjim ne shkolle, pune jete e të tjera.

Merruni me ndonjë sport që u pëlqen, bëni ushtrime fizike, mos humbisni durimin, duhet të dini që gjërat e mira nuk vijnë menjëherë, po të leni pirjen e duhanit, të alkoolit, ose i largoheni shoqërisë pijetarëve, kjo do të thotë se e doni ndryshimin dhe jeni në rrugë të mbare.

Ato qe përdorin droga të forta duhet të këshillohen me një psikolog, toksikolog, sepse ndalimi i menjëhershëm (brutal) mund të jete me pasoja të renda deri në vdekje, kjo mund të fillohet në një stacionar (spital) për ato që janë të varur. Pra, sido që varësia nga droga mund të lehtësohet, duhet të dihet se këto gjithë jetën janë persona të prekshtëm dhe për pak gjë mund t'i rikthehen vesit të vjetër sepse në trurin e tij do të vazhdoje reklamimi i drogës (epshi për droge është vetëm i fjetur) për të lehtësuar eliminimin e drogave të lehta duhan, alkool, ndihmojnë edhe disa bime si: hurma arabie, vaj kokosi, selino, pjepri i hidhur, pra, më e mire është të arrini të kontrolloni veten e të mos provoni një droge se kjo do tu beje të vuani gjithë jetën dhe do të bëheni i varur nga ajo.

Kujdes!!

Përgatiti : Dr. Med. **NDUE NIKAJ**

THETHI NA MIREPRET

50 VJET, PARK KOMBETAR

**Përgatiti Gjon Fierza,
Agjencia Kombetare e Mjedisit**

Shqipëria e vogel në sipërfaqe, tokë e bekuar e bukurive të pafundme. Ndër mjediset natyrore malore përzgjedhja e parë për të vizituar është Paku Kombëtar i Thethit, në zemër të Alpeve. Thethi është një ndër zonat më të veçanta të turizmit malor. Në Theth mund të gjeni një natyrë praktikisht të virgjër, mund të vizitoni kishat, kullat, shtëpitë tradicionale dhe mjaft monumente të natyrës. Aty ju presin njerëz mikprites dhe të dashur. Thethi listohet i pari në dhjetë fshatrat turistik më të mirë të Shqipërisë i ndjekur nga Voskopoja në Korçë dhe Bënja në Permet. Ky vlerësim është bërë duke marrë në konsideratë elemente, si : natyra e ekosistemi, tradita e kulinaria, infrastruktura e mundësitë akomoduese

PARKU KOMBËTAR "THETHI"

Me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 96, datë 21.11.1966, zona malore e Thethit, me sipërfaqe 2 630 ha, shpallet "Park Kombëtar".

Parku i Thethit ndodhet në Alpet e Shqipërisë, pranë Bjeshkëve të Nemuna. Thethi është qendra turistike-alpinistike më e rëndësishme e zonës veriore, 70 – 75 km larg qytetit të Shkodrës..

Ai kufizohet nga majat e larta shkëmbore, që bien thikë në luginë dhe krijojnë pamje të papërsëritshme; të tilla janë maja e Radohimës (2568 m), Arapit (2217 m), Paplukës (2569 m), Alijes (2471 m) etj. Në lartësitë 750 – 800 m, poshtë në luginë, shtrihet fshati piktoresk i Thethit. Këtu buron, lumi i Thethit, i cili, pasi bashkohet me përroin e Kaprrekut, në fshati Nderlyaj, formojnë lumin e Shalës, i cili derdhet në Drin. Lumi i Thethit, i kethjellët e i shkumëzuar, me prurje 1000 – 1300 l/sek e temperaturë mesatare uji 7°C, është i pasur edhe me troftën e malit. Kanioni në grykën e Shkallës së Thethit, vend i pëllumbave të egër, ka lartësi rreth 40 m e gjerësi 1 m. Ujevara e Grunasit është piktoreske e mahnitëse, me rënie të ujit mbi 30 m lartësi.

Bien afro 2400 – 2500 mm shi në vit. Shtresa e dëbores arrin në 1.5 – 2.5 m dhe zgjat 130 – 160 ditë, kurse në disa pika të veçanta të parkut dëbora është e përhershme, gjë që shton vlerat për turizëm.

Parku është kompleks, me larmi habitatesh dhe tipe vegjetacioni, ku pjesën më të madhe e zenë ato të pyjeve të ahut, por ka edhe formacione shkurre me mbizotërim boronice apo kullotash

subalpine që bashkëshoqërohen dhe me shkurre xhuxhe dhe të zonave alpine, etj. Në këtë park ka rreth 1500 lloje bimësh, që përfaqësojnë gati gjysmën të florës së

vlerësuar është prania e drurit relik të tisisit (Taxus baccata) brenda katit drunor të pyllit të ahut, megjithëse në ekzemplarë të rrallë, si dhe e bimëve endemike

(Capreolus capreolus).

Thethi është vendbanim shumë i hershëm i lidhur me atë të fisit ilir të



Në bazë të vendimit të KM, Nr. 676, datë 20.12.2002, në park apo në afërsi të tij, janë shpallur monumente natyre:

- Ujvara e Thethit,
- Shpella e Thethit,
- Cirkui i gropës së Jezercës,
- Liqeni i Jezercës,
- Pisha flamur e qafës së Pejës,
- Burimet e Okolit,
- Shpella e majës së Arapit,
- Kalaja e shtegut të dhenve

(Ëlfenia baldaccii; Viola dukagjinica, Lilium albanicum). Bimë subendemike janë: Aquilegia dinarica dhe Teucrium arduini.

Fauna e parkut është e pasur dhe e larmishme. Ka rreth 20 lloje gjitarësh, 50 lloje shpendësh follenizuese, afro 10 lloje zvarranikësh, rreth 8 lloje amfibësh. Rëndësi paraqesin gjitarët dhe shpendët e lidhur me pyjet e lartë dhe ekosistemet malore e alpine. Ndër gjitarët e mëd-

vendit tonë. Nga bimët, rreth 100 lloje janë bimë mjekësore e tanifere shumë të dobishme. Rreth 70 lloje janë të rrezikuara për zhdukje, të rralla etj. Për t'u

henj të parkut të Thethit përmendim pratinë e ariut (Ursus arctos), ujkut (Canis lupus), rrëqebullit (Lynx lynx), dhisë së egër (Rupicapra rupicapra) dhe kaprollit

Labeatëve. Pasuritë natyrore të kësaj zone janë të lidhura ngusht edhe me trashëgiminë kulturore dhe historike të banorëve vendas, duke formuar kështu, bazat më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit. Thethin, si vend shumë i përshatshëm për turizëm, krahasohet me viset e bukura të Tirolit, Austri.

Bukuritë e papërsëritshme të këtij fshati malor në zemër të Alpeve shqiptare, lugina me lumin me ujrat e kristalta e bëjnë Thethin që të zërë një vend të rëndësishëm në natyrën dhe turizmin shqiptar. Duke u nisur nga veçoritë e tij dhe nga vendndodhja pranë kufirit, Parku Kombëtar i Thethit është propozuar që të jetë pjesë e një parku ndërballkanik të quajtur **Parku i Paqes**, ku të përfshihen terriore edhe nga Kosova dhe Mali i Zi.



REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION **Kimay** Produzione Giacche

